

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5983  
E enjte, 23 janar 2020  
çmimi 0.40 €

## Kryetari Jashari: Sulmi i 22 janarit ishte paralajmërim që lufta do të fillojë shpejt



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR REXHEPI | FAQE 4-5

## TË DYJA PARTITË DUHET TË BËJNË KOMPROMISE



Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka bërë me dije se për të arritur të marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës duhet të bëjnë kompromise. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka

ftuar liderin e LV-së, Albin Kurti dhe atë të LDK-së, Isa Mustafa, që t'i kthehen tavolinës së bisedimeve për ta përmbyllur marrëveshjen brenda kësaj jave. Rexhepi ka thënë se përgjegjësia më e madhe për kompromis i takon LV-së, e cila ka dalë fituese në zgjedhjet e 6 tetorit. Sipas tij, dërgimi i vendit në zgjedhje të reja do të ishte një gabim i madh i të dyja subjekteve politike

### OPINION

#### KOALICIONI BASHKËQEVERISËS MIDIS LV-SË DHE LDK-SË DUKET TË JETË I PASHMANGSHËM DHE PA ALTERNATIVË F. 12

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



#### 22 VJET NGA SULMI I DYTË SERB NË FAMILJEN JASHARI F. 11

Nga Jakup  
KRASNIQI



#### LIGJI I ENERGJISË MAGNETIKE F. 11

Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE

#### GJYKATA SHPALL FAJTORË PJESËTARËT E GRUPIT 'SYRI I POPULLIT' F. 7

### EKONOMI

#### QEVERIA MIRATON VENDIMIN PËR THEMELIMIN E ZONËS EKONOMIKE ZVICERANE F. 3

#### TARIFA PREJ 100 PËRQINDËSH NUK ËSHTË SHTYLLA E ZHVILLIMIT EKONOMIK NË KOSOVË F. 9



## Kolegji ISPE fton Prokurorinë ta hetojë Agjencinë e Akreditimit



## FIGURA TË REJA MARRIN PËRGJEGJËSI UDHËHEQËSE NË PDK



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zgjedhur të mërkurën nënkryetarët, sekretarin e ri dhe udhëheqësit e 13 departamenteve në këtë parti. Sekretar i përgjithshëm i PDK-së është zgjedhur Uran Ismaili, ndërkaq nënkryetarë janë zgjedhur Agim Aliu dhe Shaqir Totaj. Kurse Hajredin Kuçi dhe Enver Hoxhaj, që më herët mbanin postet e nënkryetarëve, tashmë janë udhëheqës të departamenteve në PDK. Kuçi është emëruar udhëheqës i Departamentit për Politika Programore, ndërkaq Hoxhaj udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Ambasadorja amerikane Yuri Kim mbërrin në Shqipëri

TIRANË, 22 JANAR - Trembëdhjetë ditë pasi bëri betimin në Departamentin Amerikan të Shtetit, ka arritur në Shqipëri shefja e re e diplomacisë së Uashingtonit në Tiranë.

Pas një qëndrimi të shkurtër në terminalin VIP nga ku u prit prej stafit të Ambasadës ajo është nisur drejt Tiranës, për të nisur të enjten ditën e parë të punës si ambasadore.

Pas Mariza Linos dhe Marcie Ries ajo është e treta diplomate femër që do të drejtojë selinë e Uashingtonit në Rrugën e Elbasanit.

Yuri Kim vjen në Tiranë pasi e nominuar e Shtëpisë së Bardhë

përpara saj Kathleen Kavalec, nuk mundi të mernte dritën jeshile nga Senati si pasojë e një lobimi kundër saj për të cilin Fiona Hill ish-këshilltare për sigurinë e presidentit Trump tha në Kongresin amerikan, se erdhi nga një parti politike në Shqipëri, ka njoftuar Top Channel.

Pasardhësja e Donald Lu, Yuri Kim ka shërbyer në Departamentin e Shtetit si drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve të Evropës Jugore.

Ka qenë drejtoreshë e Qendrës së Departamentit të Shtetit për Studimin e Diplomacisë, shefe e stafit për zëvendëssekretarin amerikan të Shtetit dhe drejtoreshë e Zyrës për Sigurinë Evropiane dhe Çështjeve Politiko-Ushtarake.



Yuri Kim është gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson ShBA-të në postin e një ambasadori dhe personi i parë nga territori amerikan i Guamit

që shërben në një post të tillë. Ajo ka lindur në Kore dhe është rritur në ishullin Guam, një territor i ShBA-së në Oqeanin Paqësor.

Ambasadorja Yuri Kim në tre vitet e ardhshme do t'i udhëheqë prioritetet e ShBA-së për Shqipërinë, duke nisur nga konsolidimi reformës në drejtësi me SPAK dhe BKH, vijimin e ndëshkimit të zyrtarëve të korruptuar, minimizimin e veprimeve të Iranit në Shqipëri, përfshi influencën ruse, pa haruar shqetësimin më të fundit amerikan, përpjekjet e Kinës në kontrollin e disa sektorëve strategjikë në Shqipëri.

# Gjyqi ndaj Trumpit mund të ndikojë në zgjedhjet e sivjetme

Duke qenë se gjasat janë që gjyqi në Senat të nxjerrë atë të pafajshëm, Trumpi shpreson të vendosë një tjetër rekord historik duke u bërë presidenti i parë i akuzuar për shkarkim që do t'i fitojë sërish zgjedhjet

WASHINGTON, 22 JANAR - Presidenti Donald Trump ka hyrë tashmë në histori si presidenti i tretë i Shteteve të Bashkuara ndaj të cilit janë ngritur akuza për shkarkim nga Dhoma e Përfaqësuesve. Duke qenë se gjasat janë që gjyqi në Senat të nxjerrë atë të pafajshëm, ai shpreson të vendosë një tjetër rekord historik duke u bërë presidenti i parë i akuzuar për shkarkim që do t'i fitojë sërish zgjedhjet. Derisa drama e shkarkimit po zhvillohet, fushata për zgjedhjet presidenciale 2020 ka hyrë në një fazë kritike, ka njoftuar vova.

Ndërsa përballet me akuzat për shkarkimin e tij, presidenti Donald Trump parapëlqen t'i kujtojë bazës së mbështetësve të tij se çfarë do të përcaktohet në zgjedhjet e 2020-ës.

"Ne po jua kthejmë pushtetin juve, popullit amerikan. Me ndihmën tuaj, me përkushtimin dhe nxitjen tuaj, do të vazhdojmë të punojmë; do të vazhdojmë të

luftojmë dhe do të vazhdojmë të fitojmë dhe të fitojmë!", u tha mbështetësve presidenti Trump. Mbështetësit e presidentit Trump nuk kanë nevojë për t'i bindur.

"Mendoj se ka punuar për të gjithë vendin. Ai po lufton për të gjithë ne çdo ditë. Nuk di si ia del të arrijë gjithçka, por po e bën. Shumë mirë për të dhe për ne", thotë Nancy Freye, mbështetëse e presidentit Trump.

Por në Uashington, një proces më solemn kushtetues mund të ketë një impakt të madh mbi shpresat e presidentit Trump për t'u zgjedhur.

"Do të bëni drejtësi të paanshme bazuar mbi Kushtetutën dhe ligjet. Zoti ju ndihmoftë", u shpreh gjatë betimit të senatorëve kryetari i Gjykatës së Lartë, John Roberts.

Senati është shndërruar tashmë në një trup gjyqësor për presidentin Trump. Ata do të dëgjojnë çështjen e paraqitur nga ligjvënësit demokratë, të cilët



akuzojnë se presidenti Trump i bëri presion Ukrainës për ta ndihmuar të rizgjidhet.

"Me këtë lloj sjelljeje, presidenti Trump ka demonstruar se do të vazhdojë të jetë kërcënim për Kushtetutën, nëse do të lejohet të vazhdojë në detyrë", tha ligjvënësi demokrat Adam Schiff. Gjyqi ka ngjallur protesta nëpër korridore.

Udhëheqësi i demokratëve në Senat, Chuck Schumer, thotë se vendimi do të ketë pasoja shumë të mëdha për presidentin Trump dhe për vendin.

"Pesha e historisë, sytë e his-

torisë, i ndjeni se janë mbi ju", tha senatori Schumer.

Pritet që presidenti Trump të shfaqësohet nga Senati dhe të vazhdojë në detyrë.

"Shumë presidentë. Disa të mirë, disa jo aq të mirë. Por, juve keni një president të mirë tani. Megjithëse po përpiqen ta shkarkojnë. A mund t'u besoni dot syve?", u tha mbështetësve presidenti Trump.

Por, nga mënyra si do të zhvillohet gjyqi, mund të ndikohen shanset e presidentit për t'u rizgjedhur, thotë analisti John Fortier.

"Niveli i tij i miratimit nuk ka rënë, por nuk janë shifra të larta. Ai ka mbështetje të fortë nga baza e tij republikane, por vështirësohet ta shtojë atë. Pra, ai është nën pritshmëritë për një president që dëshiron të rizgjidhet", thotë John Fortier, i Qendrës për Politikën Dypartiake.

Presidentin Trump do ta ndihmojë ndoshta ekonomia e fortë dhe reputacioni se zhvillon një fushatë elektorale të ashpër, thotë Jim Kessler.

"Nuk do ta nënvlerësoja. Ai ka qenë gjithnjë president jopopullor. Ai ishte një kandidat jopopullor, por që i kthen goditjet shumë mirë", thotë Jim Kessler, i organizatës "Third Way".

Akuzat ndaj presidentit do të jenë një faktor për shumë votues në muajin nëntor, thotë Hans Noel.

"Do të ketë të bëjë me nëse Trumpi del i pafajshëm apo jo, apo nëse shkeljet që kanë lidhje me të do të jenë aq të këqija, sa që votuesit ta heqin me votë", thotë Hans Noel, i Universitetit Georgetown.

Fati i presidentit Trump në Senat do të vendoset brenda javësh. Një gjykim përfundimtar nga zgjedhësit amerikanë do të jepet në nëntor.

## Meta: Marrëdhëniet me Greqinë do të zhvillohen më tej

TIRANË, 22 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta përshëndeti të mërkurën zgjedhjen historike të presidentes së re të Greqisë, Ekaterini Sakellariopoulou.

Meta i uroi Sakellariopoulou sukses në këtë post shumë të rëndësishëm.

"Mbetem i bindur se marrëdhëniet shumë të mira dhe tradicionale mes dy vendeve edhe dy popujve tanë do të zhvillohen edhe më tej në dobi të interesave dhe qëllimeve tona të përbashkëta, ku kontributi i presidentes së zgjedhur të Republikës Helenike, Ekaterini Sakellariopoulou, është i një

rëndësie të veçantë", thekson Meta. Parlamenti grek zgjodhi të mërkurën Ekaterini Sakellariopoulou, 63 vjeçe, presidente të Greqisë. Sakellariopoulou mori që në raundin e parë votat e 261 deputetëve nga 300 të tillë.



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zgjedhur nënkryetarët, sekretarin e ri dhe udhëheqësit e departamenteve

# Figura të reja marrin përgjegjësi udhëheqëse në PDK



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zgjedhur të mërkurën nënkryetarët, sekretarin e ri dhe udhëheqësit e 13 departamenteve në këtë parti. Sekretar i përgjithshëm i PDK-së është zgjedhur Uran Ismaili, ndërkaq nënkryetarë janë zgjedhur Agim Aliu dhe Shaqir Totaj. Kurse Hajredin Kuçi dhe Enver Hoxhaj, që më herët mbanin postet e nënkryetarëve, tashmë janë udhëheqës të departamenteve në PDK. Kuçi është emëruar udhëheqës i Departamentit për Politika Programore, ndërkaq Hoxhaj udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare

**EPOKA  
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryesia e re e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në mbledhjen e parë të mbajtur të mërkurën ka zgjedhur dhe plotësuar strukturën e re drejtuese të partisë, duke emëruar nënkryetarët, sekretarin dhe një numër udhëheqësish të departamenteve sektoriale.

Uran Ismaili është emëruar sekretar i përgjithshëm i PDK-së; Agim Aliu, nënkryetar; Shaqir Totaj, nënkryetar; Abelard Tahiri, udhëheqës i Departamentit për Çështje Organizative; Betim Gjoshi, udhëheqës i

Departamentit për Çështje Elektorale; Blerand Stavileci, drejtor ekzekutiv i partisë; Hajredin Kuçi, udhëheqës i Departamentit për Politika Programore; Enver Hoxhaj, udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare; Elmi Reçica, udhëheqës i Departamentit për Çështje të Diasporës; Sami Lushtaku, udhëheqës i Departamentit për Vlera të Luftës; Xhavit Haliti, udhëheqës i Departamentit për Grupe të Interesit; Migjen Kelmendi, udhëheqës i Departamentit për Media dhe Rrjete Sociale; Muzafer Shala, udhëheqës i Departamentit për Rini dhe Inovacion; Safete

Hadërgjonaj, udhëheqëse e Departamentit Financa dhe Anëtarësi; Bajrush Xhemajli, Udhëheqës i Departamentit për koordinim me deputetë, ekzekutivin dhe asamblistët; Blerta Deliu-Kodra, udhëheqëse e Departamentit Çështje Gjinore.

Kryetari Kadri Veseli dhe Kryesia e PDK-së përgëzuan të porsazgjedhurit për përgjegjësitë e reja, duke vlerësuar lart demokracinë e brendshme të shfaqur gjatë procesit zgjedhor. Po ashtu, u rikonfirmua zotimi për fuqizimin e angazhimit të mëtejshëm politik në pajtim me pritshmëritë e qytetarëve dhe sfidave të cilat po i kalon vendi.

## Misioni vëzhgues i BE-së: Financimi i fushatës për zgjedhjet e 6 tetorit kishte mungesë transparence

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka pritur të mërkurën në takim anëtarin e Parlamentit Evropian, Viola Von Cramon-Taubadel, e cila është edhe kryesuese e Vëzhguesve të Misionit të Zgjedhjeve të BE-së. Ajo shoqërohej nga bashkëpunëtorë dhe nga përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Në emër të KQZ-së, kryetarja Daka ka pranuar raportin përfundimtar të Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës që u mbajtën më 6 tetor 2019.

Edhe kryetari i Kuvendit të


Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim anëtarin e Parlamentit Evropian, me të cilën ka diskutuar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit të kaluar dhe ecurinë e tyre. Duke falënderuar misionin e BE-së për kontributin e tyre në mbarëvajtjen e këtij procesi, edhe pse në cilësi të vëzhguesit, kryeparlamentari Konjufca ka theksuar se organizimi i zgjedhjeve në Republikën e Kosovës tashmë ka arritur një nivel të kënaqshëm, dëshmia më e mirë të cilit është vetë pranimi i rezultatit zgjedhor nga të gjitha subjektet politike garuese.

Kryesuesja e këtij misioni, Von Cramon-Taubadel, ka theksuar në mënyrë të veçantë faktin se zgjedhjet, duke marrë parasysh afatin e shkurtër kohor për t'u përgatitur, kanë qenë demokratike, të organizuara dhe të përgatitura shumë mirë. Ajo ka thënë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë punë shumë të mirë, duke përgatitur në kohë materialet, gjë që duhet theksuar për shkak të kompleksitetit të procesit. Problem serioz të këtyre zgjedhjeve, Von Cramon-Taubadel, potencoi mungesën e transparencës për financimin e fushatës.



Flet për "Epokën e re", Fatmir Rexhepi

# Të dyja partitë duhet



Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka bërë me dije se për të arritur te marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës duhet të bëjnë kompromise. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka ftuar liderin e LV-së, Albin Kurti dhe atë të LDK-së, Isa Mustafa, që t'i kthehen tavolinës së bisedimeve për ta përmbyllur marrëveshjen brenda kësaj jave. Rexhepi ka thënë se përgjegjësia më e madhe për kompromis i takon LV-së, e cila ka dalë fituese në zgjedhjet e 6 tetorit. Sipas tij, dërgimi i vendit në zgjedhje të reja do të ishte një gabim i madh i të dyja subjekteve politike

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 JANAR - "Epoka e re": Z. Rexhepi, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës ende nuk kanë arritur një marrëveshje edhe tre muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit. Pse?

**Rexhepi:** Qëndron fakti që thoni ju, se për një kohë të gjatë LV-ja dhe LDK-ja nuk kanë arritur një marrëveshje përfundimtare, sado që ato marrëveshje preliminare kanë arritur t'i mbajnë, të cilat kanë pasur të bëjnë me programe dhe disa çështje të qeverisë. Megjithatë, të gjithë kemi

pritur se marrëveshja përfundimtare do të ndodhë më shpejt. Bazuar në deklaratat parazgjedhore dhe paszgjedhore të zyrtarëve të dy partive, çdo qytetar ka pritur se lidhshipi i LV-së dhe lidhshipi i LDK-së do ta përfundojnë këtë marrëveshje mbi bazën e saj se si duhet të ndahet pushteti midis dy partive, kur njëra ka fituar 29 deputetë e tjera 28.

Po ta lexojnë drejt këtë rezultat edhe LV-ja dhe LDK-ja, mendoj se u kanë hyrë në hak qytetarëve dhe elektoratit që i kanë votuar. Tanimë jemi ku jemi. Ka pasur përpjekje dhe lëshime për marrëveshjen nga të dyja anët, qoftë nga lideri i LV-së apo qoftë nga

lideri i LDK-së. Ashtu siç ka deklaruar LDK-ja pas mbledhjes së fundit të kryesisë, unë besoj se brenda kësaj jave është e rendit t'i jepet përkrahje e plotë e vazhdimit të negociatave në mënyrë që të arrihet marrëveshja përfundimtare. Mbi bazën e atyre dy propozimeve ta gjejnë një kompromis, qoftë në modelimin e qeverisë apo në çështjen e presidentit. Kështu që t'i japim fund kësaj odisejade politike.

"Epoka e re": Janë bërë publike dy propozimet përfundimtare të LV-së dhe të LDK-së, ndërsa zyrtarët e të dy partive kanë thënë se nuk do të lëvizin nga ato qëndrime. Si mund të arrihet një

# të bëjnë kompromise

si dhe të jepet mendimi për çështjen e presidentit që është kërkuar nga LDK-ja. Tri pozitat kryesore nuk mund t'i ketë vetëm njëra parti, pra cilado qoftë ajo parti. Siç e dini, unë më herët kam dhënë mendimin personal që të ndahet pozitat e kryetarit të Kuvendit dhe qeverisë, kurse presidenti të mbetet për më vonë për t'u diskutuar. Kjo nuk ka ndodhur, sepse tani kryeparlamentari është zgjedhur në mënyrë legale dhe legjitime, ndërsa tani është çështja te vullneti i Vetëvendosjes, si e vlerëson ajo këtë situatë të re. Pra, të dyja palët duhet të bëjnë kompromise. Unë nuk dua të propozoj asgjë konkrete në këtë drejtim, sepse këto i kam bërë në forumet e partisë. Shpresoj se kësaj çështje i ka ardhur fundi dhe brenda kësaj jave t'i themi po këtij koalicioni.

**"Epoka e re":** LDK-ja po kërkon postin e kryeparlamentarit, kurse LV-ja ka thënë se kjo është çështje e mbyllur. Si të veprohet me këtë post?

**Rexhepi:** Për mendimin tim kryeparlamentari tashmë është zgjedhur, është legal dhe legjitim. Unë personalisht nuk dua të flas se si duhet ta gjejmë modelin e kompromisit. Se qysh do t'i ndajnë ministrinë, jo qysh ka qenë më herët, si dhe pajtimi i plotë i LV-së lidhur me propozimin dhe mënyrën e zgjedhjes së presidentit bashkë me LDK-në i takon lidhshimit të dy partive të vendosin. Pra, duhet të ekzistojë një pajtim mes partive për këto çështje. Mendoj se kjo do të arrihet brenda këtyre ditëve, nëse kanë vullnet ta bëjnë një gjë të tillë. Besoj se ka ende kohë që mund të zgjidhet ky problem.

**"Epoka e re":** Çfarë nëse këto dy parti s'arrijnë të pajtohen për bashkëqeverisje?

**Rexhepi:** Për hir të kontratës që kanë pasur me elektoratin LV-ja dhe LDK-ja, pavarësisht prej dallimeve që kanë pasur dhe kanë, besoj se nuk ishte dashur të vijnë deri në këtë moment. Jam kundër asaj që këto dy parti të mos merren vesh.

LV-së si parti e parë i takon posti i kryeministrit dhe në këtë drejtim është mirë që ajo të reflektojë, sepse ngjarjet historike nuk përsëriten në kushte të njëjta, në rrethana të njëjta dhe në mundësi të njëjta, sado që mund të ketë perceptime opinioniste nga jashtë. Mendoj se për të shfrytëzuar këtë shans që ia ka dhënë qytetari i Kosovës, duhet të reflektojë, të bëjë kompromis me LDK-në, të pajtohem për çështjen e presidentit dhe ta zgjedhim qeverinë. Në të kundërtën, do të ishte gabimi më i madh, në radhë të parë i LV-së dhe pastaj aq sa i takon edhe LDK-së. Këto dy

subjekte politike e kanë krijuar frymën që Kosovës i duhet një ndryshim. U kanë premtuar një shpresë të re qytetarëve dhe u kanë premtuar qytetarëve një qeveri model për të ardhmen e vendit. Pra, nuk duhet të lejohet që këto parti të mos pajtohen. Nëse kjo ndodhë do të ishte gabimi më i madh zgjedhor dhe demokratik që i ka ndodhur këtij vendi pas zgjedhjeve.

**"Epoka e re":** Në rast se këto parti nuk do të pajtohen, jeni për zgjedhje të reja, apo duhet të shikohen alternativa të tjera për formimin e qeverisë së re?

**Rexhepi:** Po e përsëris edhe një herë, unë jam kundër që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Vendi tonë i duhet një qeveri e cila duhet të merret brenda mundësve me të gjitha çështjet dhe problemet që ballafaqohet

Kosova. Në këtë situatë askush nuk e ka komoditetin ta çojë vendin në zgjedhje. Prandaj po them, lideri i LV-së me ekipin e vet dhe lideri i LDK-së me ekipin e vet duhet të ulen dhe ta krijojnë mirëbesimin për ta arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje. Në të kundërtën, do të ishte gabimi më i madh i tyre sipas përgjegjësisë së tyre politike që kanë pasur para elektoratit.

## Qeveria miraton vendimin për themelimin e Zonës Ekonomike Zvicerane

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën ka miratuar vendimin për krijimin e Grupit Punues për themelimin e Zonës Ekonomike Zvicerane, ka shqyrtuar Programin e Reformave në Ekonomi për vitin 2020 dhe vendime të tjera nga fushat e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Me vendimin e miratuar nga kabineti qeveritar është themeluar Grupi Punues për themelimin e Zonës Ekonomike Zvicerane.

Grupi punues ka për detyrë, bazuar në Ligjin për Zonat Ekonomike, ta identifikojë legjislacionin, lokacionin, procedurat dhe të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme që mundësojnë themelimin e Zonës së Ekonomike Zvicerane.

Si rezultat grupi punues do ta përgatisë tërë dokumentacionin relevant bazuar në legjislacionin në fuqi që i mundëson Qeverisë së Republikës së Kosovës themelimin e Zonës Ekonomike Zvicerane.

Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike i është vazhduar mandati me vendim të qeverisë edhe për një periudhë trevjeçare. Edhe drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës i është vazhduar mandati për tre

vjet.

Nga kabineti qeveritar ka marrë aprovimin edhe Programi për Reforma në Ekonomi 2020.

Ministria e Financave këtë dokument do ta dorëzojë te Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, ndërsa sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, Programin për Reforma në Ekonomi do t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Programi për Reforma në Ekonomi dorëzohet në Komisionin Evropian në baza të rregullta vjetore dhe përgatitet nga Zyra për Planifikim Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit, Departamentit për Politika Ekonomike dhe Publike në kuadër të Ministrisë së Financave dhe koordinatorët e ministrive përkatëse dhe është mjet përmes të cilit Komisioni Evropian monitoron performancën tonë si shtet kandidat potencial për transformimin e ekonomisë dhe arrijtjen e standardeve të tregut Evropian.

Në këtë mbledhje, Qeveria ka miratuar Rregulloren për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura.

Qeveria i ka rekomanduar presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë Ministrinë e

Financave për nënshkrim të marrëveshjes së kredisë mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unikredit Bank Austria AG, për financimin e projektit "Krijimi i Qendrave e-Testuese dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i shërbimeve të e-Arsimit për arsimin para universitar në Kosovë". Shuma e kredisë së negociuar është 4,998,000 (katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) euro.

Edhe vendimi për aprovimin e nismës për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë në fushën e transportit rrugor ndërkombëtarë të udhëtarëve dhe mallrave është miratuar sot në mbledhjen e qeverisë. Në mbledhje është aprovuar Rregullorja për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Integritimit Evropian është emëruar Koordinator Nacional për Donacione, IPA, TAIEX dhe programet e tjera që ofrojnë donacione për Republikën e Kosovës. Për nevojat e pagesës së dymbëdhjetë punonjësve të angazhuar në Rezidencën "Ibrahim Rugova" për vitin 2020, qeveria ka ndarë mjetet në vlerë 57,944 (pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) euro.



kompromis, pra kush duhet të lëshojë pe?

**Rexhepi:** Nuk do të thosha se kush duhet të lëshojë pe sepse nuk është aty çështja. Megjithatë, unë mendoj se ka rëndësi të lexohet drejt rezultati zgjedhor. Dorën në zemër, në këtë rast LV-ja duhet ta marrë përgjegjësinë më të madhe, por edhe LDK-ja duhet ta di se ka nevojë për një kompromis final. Propozimet e fundit të dy subjekteve politike nuk i llogarit si propozime përfundimtare, sepse mendoj se duhet të ulen në tavolinën e bisedimeve dhe ta arrijnë marrëveshjen përfundimtare. Duhet të shikohet modelimi i qeverisë, duke shtuar numrin e ministrive

# Kolegji ISPE fton Prokurorinë ta hetojë Agjencinë e Akreditimit

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Kolegji ISPE ka ftuar Prokurorinë e Shtetit që t'i trajtojë rastet e fundit të akreditimit të programeve të disa institucioneve private të arsimit të lartë. Ky reagim ka ardhur pas dyshimeve që i kanë ngritur edhe disa anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Bordit të Agjencisë së Akreditimit) si dhe organizata ORCA për manipulim të procesit të akreditimit në mbledhjen e fundit të Bordit.

ISPE-ja, në reagimin e saj, ka thënë se u bashkohet thirrjeve të fundit të disa anëtarëve të Bordit të Agjencisë për Prokurorinë për të ndërmarrë hetime rreth manipulimeve dhe orkestrimeve të procesit të akreditimit. Ky kolegji ka theksuar se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me organet kompetente të shtetit në këtë drejtim. "Kolegji ISPE iu bashkohet thirrjeve të fundit të disa anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Akreditimit (KSHC) për prokurorinë e shtetit për të ndërmarrë hetime sa iu përket manipulimeve dhe orkestrimeve të procesit të akreditimit nga ana AKA-së. Ne nga Kolegji ISPE ofrojmë gatishmërinë tonë për bashkëpunimin e plotë me organet kompetente të shtetit në këtë drejtim. Gjithashtu, përmes kësaj komunikate dëshirojmë ta informojmë opinionin e gjerë publik, por edhe institucionet, se thirrjet e disa anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Akreditimit (KSHC), që iu referohen



orkestrimeve dhe manipulimit të procesit të akreditimit nga ana e vet Agjencisë në fjalë. Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen se thirrjet e fundit të disa anëtarëve të Bordit të AKA-së nuk përfshijnë të gjitha shkeljet ligjore të kryera nga ana e këtij institucioni. Ne dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen e opinionit të gjerë dhe institucioneve të Kosovës", është theksuar në komunikatën e ISPE-së.

ISPE-ja ka theksuar se edhe pas përjashtimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ENQA dhe EQAR-i nuk është ndërmarrë asnjë masë për përmirësimin e situatës në këtë agjenci nga ana e

institucioneve të Kosovës.

Kolegji ISPE ka paraqitur në këtë komunikatë disa prej shkeljeve të Agjencisë së Akreditimit: I. Përjashtimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ENQA dhe EQAR; II. Veprimtaria e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në raport me Kolegjin ISPE pas përjashtimit të saj nga ENQA dhe EQAR; III. Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Avokati i Popullit dhe IV. Hetim nga një Komision i Specializuar Ndërkombëtar për vendimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim ndaj Kolegjit ISPE. "Edhe pas përjashtimit të Agjencisë së Kosovës për

Akreditim nga ENQA dhe EQAR nuk është ndërmarrë asnjë masë për përmirësimin e situatës në këtë Agjenci nga ana e institucioneve të shtetit të Kosovës. Përkundrazi çështja e përjashtimit është heshtur dhe nuk përmendet fare, edhe pse kjo është humbja më e madhe në sistemin e arsimit të lartë në dy dekadat e fundit", është thënë në këtë komunikatë.

ISPE ka vlerësuar se Prokuroria e Shtetit duhet t'i orientojë hetimet për të zbuluar se cilat janë shkaqet që çuan deri në përjashtimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe kush janë

përgjegjësit e kësaj situatë me pasoja të mëdha për më shumë se 100 000 studentë kosovarë. "Agjencia e Kosovës për Akreditim qëllimshëm ka vonuar trajtimin e aplikacionit të Kolegjit ISPE deri në momentin e skadimit të afatit të lejeve të qëndrimit të stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE. Në momentin e skadimit të afatit të lejeve të qëndrimit të stafit të deklaruar nxjerr vendim për refuzimin e tërësishëm të Kolegjit ISPE, me arsyetimin se lejet e qëndrimeve të stafit të deklaruar kanë skaduar. Ftojme Prokurorinë e Shtetit që në mënyrë specifike ta hetojë edhe këtë rast, ndër të tjera, shkelje të Agjencisë së Kosovës për Akreditim", thuhet në komunikatën e Kolegjit ISPE. ISPE-ja ka vlerësuar se duke parë që, pavarësisht prej shkeljeve të vazhdueshme nga AKA-ja në raport me Kolegjin ISPE, përjashtimit të saj nga ENQA dhe EQAR, letërsë Institucionit të Avokatit të Popullit dhe raporteve të Inspektoratit të Arsimit, i cili gjen se AKA-ja kishte nxjerrë vendime të paligjshme në raport me Kolegjin ISPE, nuk është ndërmarrë asnjë masë në funksion të përmirësimit të gjendjes, Kolegji ISPE ka filluar një proces i cili ka qëllim të shpie në një moment ku një komision ndërkombëtar do ta hetojë në mënyrë të pakufizuar AKA-në për gjithë veprimtarinë e saj në raport me Kolegjin ISPE", është theksuar në këtë komunikatë.

## Komuna e Prishtinës dhe USAID-i me marrëveshje për trajtimin e ndërtimeve pa leje

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me USAID-in për zbatimin e programit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar përshkruan asistencën teknike të USAID-it dhe mbështetjen për komunikim me publikun, për të ndihmuar në adresimin e çështjes në shkallë të gjerë të ndërtimeve pa leje (legalizimi) dhe për ta përmirësuar procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit. "Procesi i legalizimit është një ndër proceset më të rëndësishme në Kosovë, ku besohet se në Kosovë do të trajtohen 300 mijë shkelje të ndryshme që nga paslufta. Në Komunën e Prishtinës janë 50 mijë shkelje nga viti '99. Ligji i legalizimit është tentativa e fundit për të rregulluar.

Të gjitha ndërtimet deri në shtator 2018 do të mund të trajtohen për legalizim. Deri më tani ky proces nuk ka qenë i suksesshëm. Sepse shumica e njerëzve nuk kanë aplikuar për legalizim për arsye të ndryshme. Tashmë ka kaluar edhe ligji i ri i cili e bën të gjithë procesin më të lirë dhe më efektiv. Prandaj, ftoj të gjithë qytetarët që ta shfrytëzojnë këtë rast dhe të aplikojnë për t'i legalizuar pronat e tyre", ka thënë kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.

Joshua Mike, drejtor i Zyrës së Rritjes Ekonomike në Misionin e USAID-it në Kosovë, ka inkurajuar qytetarët e Prishtinës që të përfitojnë nga ky proces i rëndësishëm dhe menjëherë t'i paraqesin kërkesat e tyre për legalizimin e ndërtimeve pa leje. "Ne dëshirojmë ta falënderojmë paraprakisht kryetarin e komunës, z. Ahmeti, për reagimin ndaj kërkesave të qytetarëve dhe për bashkëpunimin e komunës me



qeverinë kombëtare. Ky proces i legalizimit dhe zbatimi i plotë i kësaj marrëveshjeje është një mundësi si për komunën ashtu edhe për Qeverinë e Kosovës për t'u treguar qytetarëve që janë të përkushtuar dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Ne jemi partneri juaj në këtë përpjekje. Ne do të jemi përkrah jush për të ofruar mbështetje, për të siguruar që kjo përpjekje e rëndë-

sishme, por sfiduese, do të jetë efektive dhe transparente", ka thënë Mike.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje është një proces i rëndësishëm që mund të ndihmojë në qartësimin e të drejtave pronësore të qytetarëve individualë dhe formalizimin e kapitalit të konsiderueshëm të bllokuar në ndërtimet ekzistuese pa leje. Ndërsa më herët janë identifikuar

mbi 352 000 ndërtime pa leje nga komunat dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, procesi aktual ka nisur me miratimin e Ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje në vitin 2018. Ky proces i ri u lejon qytetarëve që t'i dorëzojnë kërkesat përfundimtare për legalizim dhe regjistrim në kadastër të ndërtesave pa leje. Aplikimi nga pronarët e ndërtesave pa leje, me një përpunim efektiv, transparent dhe në kohë nga komunat, është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të procesit të legalizimit. Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me USAID-in do t'i koordinojë aktivitetet e komunikimit me publikun, për t'i inkurajuar qytetarët që të aplikojnë për legalizim dhe, gjithashtu, do t'i ndihmojë zyrtarët komunalë për thjeshtësimin e proceseve administrative brenda komunës për të ndihmuar në zbatimin e programit.

# Gjykata shpall fajtorë pjesëtarët e grupit 'Syri i Popullit'

Prishtinë, 22 janar - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur fajtorë të akuzuarit në rastin e njohuri si "Syri i Popullit". Të akuzuarit janë shpallur fajtorë për përgatitje të veprave terroriste. Sipas Gjykatës, të akuzuarit planifikonin vrasjen e shumë zyrtarëve të lartë në Kosovë, duke përfshirë presidentin Hashim Thaçi dhe ish-kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli. Sadri Ramabaja është dënuar me 5 vjet burgim, Avni Llumnica me dënim unik prej 12 vjetësh burgim, Ragip Sallova me 4 vjet burgim, Behxhet Luzha me 2 vjet burgim, Halim Halimi me 3 vjet burgim, Bajrush Konjusha me 3 vjet burgim, ndërsa i akuzuari tjetër, Rexhep Topllana, me 2 vjet burgim. Të dënuarve gjykata ua ka njohur kohën sa kanë qëndruar në paraburgim. Ndërsa për Murat Jasharin, i cili kreu tentimvrasje ndaj avokatit Azem Vllasi, Gjykata vendosi që ta dërgojë atë për 10 vjet ndalesë në institucione shëndetësore për shkak të gjendjes së tij psikike. Emri i organizatës "Syri i

Popullit" u bë i njohur më 12 mars të vitit 2017, kur në orët e hershme të atij mëngjesi, Murat Jashari, një aktivist politik i viteve '90, trokiti në derën e banesës së avokatit Azem Vllasi në Prishtinë për ta vrarë atë. Pak sekonda pasi Vallasi hapi derën, Murat Jashari shkrep armë zjarri duke tentuar që ta vraste Vllasin. Pas pak kohësh nisën arrestimet e para ku, pos Murat Jasharit që kreu tentimvrasjen, u arrestua edhe Avi Llumnica. Këta dy persona u arrestuan nën akuzat se ishin pjesëtarë të organizatës "Syri i Popullit", e cila mori përgjegjësinë për tentimvrasjen e Azem Vllasit. Hetuesia zgjeroi hetimet duke arrestuar edhe persona të tjerë si Bajrush Konjusha, Ragip Sallova, Sadri Ramabaja, Rexhep Topllana, Sabit Berisha, Halim Halimi, Bexhet Luzha dhe Lirije Luzha. Arrestimi më i bujshëm sa iu takon pjesëtarëve të kësaj organizate ishte ai i pjesëtarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Sadri Ramabaja, arrestimi i të cilit ndodhi më 7 tetor të vitit 2017. Ramabaja u arrestua në portin



e Durrësit në Shqipëri derisa tentonte që të largohej nga ky vend me pasaportë dhe leje-qëndrimi të falsifikuar franceze, kishin njoftuar autoritetet e Shqipërisë. Gjatë seancave gjyqësore në këtë proces, Ramabaja ishte i zëshëm në kundërshtimin e akuzave me të cilat ai ngarkohej, duke thënë se rasti ishte i montuar politikisht, me qëllim të eliminimit të tij nga skena publike. Në një dokument prej më shumë se 70 faqesh Prokuroria Speciale e Kosovës akuzonte organizatën "Syri i Popullit" se

planifikonte veprimtari terroriste në Kosovë. Sipas aktakuzës, pjesëtarët e kësaj organizate po planifikonin shkatërrimin e strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të shtetit të Kosovës. Prokuroria pretendonte se pjesëtarët e organizatës "Syri i Popullit" synonin që t'i arrinin qëllimet e tyre përmes sulmeve dhe mes vrasjes së personaliteteve më të larta shtetërore duke u nisur nga ish-funksionarët e lartë të Kosovës që kishin qenë aktivë nga viti 1980 deri më 1991,

duke i konsideruar ata si tradhtarë të vendit. Sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, "Syri i Popullit" po ashtu planifikonte vrasjen e disa prej funksionarëve që kishin mbajtur dhe mbanin pozita udhëheqëse nga viti 1999 deri në vitin 2016. Në aktakuzë thuhet se në listë për t'u vrarë nga kjo organizatë ishin edhe shumë emra të tjerë, si Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Isa Mustafa, Fatmir Limaj, Xhavit Haliti si dhe shumë të tjerë që nga kjo organizatë konsideroheshin tradhtarë që duhej eliminuar.

## Përrurohen ambulancat e reja specialistike të ORL-së dhe Oftalmologjisë

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka përruar të mërkurën objektin e rinovuar të Ambulancave Specialistike të Klinikës së ORL-së (Otorinolarinologjisë - Klinika për Sëmundje të Veshit, Hundës e Fytit) dhe Oftalmologjisë (Klinikës së Syve). Gjatë përrurimit ministri Ismaili ka thënë se ky objekt është i pajisur me aparaturë moderne për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të sigurta shëndetësore. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që shoh një objekt modern për ofrimin në mënyrë dinjitoze të shërbimeve shëndetësore", ka deklaruar ministri Ismaili. Ai ka theksuar se në objektin e ri do të bëhet e mundur shtimi i numrit të pacientëve që kërkojnë shërbim, duke ruajtur kështu shëndetin dhe xhepin e tyre. "Në këtë objekt të ri do të hiqen pabarazitë, shtohet numri i shërbimeve dhe do të zvogëlohen shpenzimet financiare të qytetarëve të cilët kanë kërkuar ndihmë diku tjetër deri më sot", është shprehur ministri Ismaili. Drejtori i ShSKUK-së, Basri



Sejdiu, ka thënë se në objektin e rinovuar pacientët dhe profesionistët shëndetësorë kanë kushte shumë më të mira për ofrimin dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore. "Tani në një ambient të transformuar

është një kënaqësi e veçantë pasi pacientët kanë ku të vijnë, duke respektuar radhën dhe duke pasur qasje në ambiente komode me pajisje moderne", ka deklaruar drejtori Sejdiu. Drejtori i ORL-së, Hajdin Thaçi, ka

thënë se përmes këtij investimi do të zvogëlohen edhe pakënaqësitë e pacientëve. "Pas 30 vjetësh këto hapësira janë shndërruar në hapësira moderne të pajisura me gjithë infrastrukturën përcjellëse për shërbime dinjitoze për

pacientët", është drejtori Hajdin Thaçi. Shërbimet ambulatore specialistike oftalmologjike deri më sot janë ofruar në katin përdhes të kësaj klinike, në kushte joadekuate për shërbime shëndetësore.

# 22 VJET NGA SULMI I DYTË SERB NË FAMILJEN JASHARI

(Ngjarje që meriton nderim dhe përkujtim të përhershëm)



Nga Jakup KRASNIQI

Sulmi i diversantëve serbë më 22 janar 1998 ishte një përballje e madhe në mes forcave të specializuara të Serbisë dhe familjes Jashari. Armiku këtë sulm do ta vlerësojë si disfatë të vet, pasi njësitë më elitare të Serbisë ishte tërhequr me turp dhe këtë turp vështirë që do ta përballonte. Kjo ishte hera e dytë që forcat pushtuese serbe, në përballje me UÇK-në e Adem legjendarin, po nda-

heshin me turp. Për secilin familjar të Jasharëve e pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e qartë e sidomos ishte e qartë për Adem Jasharin, se regjimi i Millosheviqit do të përgatiste sulme të tjera mbi këtë familje të cilën e vlerësonte si bazën kryesore të UÇK-së. Edhe familja Jashari po përgatitej që të mbrohej nga sulmet e armikut barbar serb. Por, përmasat e këtyre dy përgatitjeve kishin dallime të mëdha e të shumta. Serbia kishte të angazhuara të gjitha mekanizmat e të gjitha pushteteve, të atij shtetëror, mediatik, akademik e fetar. Ndërsa Familja Jashari kryesisht po mbështetej mbi fuqinë e familjes dhe të një numri të kufizuar

të shokëve pjesëtarë të UÇK-së brenda e jashtë atdheut. Ndërsa politika pacifiste dhe qeveria në ekzil nuk po e kryente asnjë obligim në shërbim të luftës mbrojtëse e çlirimtare. Asokohe kjo ishte ana më e dobët e politikës në Kosovën e pushtuar. Tani më ishte e qartë, nga institucionet pacifiste nuk pritej ndonjë gjë e mirë, në një situatë të tillë të gjitha shpresat ishin koncentruar tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe drejtuesit e saj, te Lëvizja Kombëtare për Çlirim. Më 22 janar të vitit 1998 Njësitë Ushtarake të UÇK-së në Prekaz, e veçanërisht familja Jashari, që mbrojtur me sukses në përballje me diversantët e dërguar nga shteti serb. Komandanti i UÇK-së, Adem Jashari dhe Jasharët u

mbrojtën me sukses për të dytën herë. Kjo përveç që ishte një fitore e madhe, ajo qëndresë po reflektonte shpresë e besim kudo ishin shqiptarët. Kjo ishte edhe një dëshmi tjetër e madhe se Ushtria Çlirimtare e Kosovës po bëhej forcë serioze politike dhe ushtarake në mbrojtje të kombit e të vendit. Ngjarjet e tilla patën bërë që: "The Daily Telegraph", gazeta me prestigjioze e Britanisë së Madhe, do të shkruajë: "UÇK-ja është e vetmja forcë që lufton për çlirimin e Kosovës". Koha tregoi se kjo ishte më shumë se e saktë! Adem Jashari dhe Ushtria e tij Çlirimtare me luftë e flijime u bënë arkitektët kryesorë e të vetëm të lirisë e të pavarësisë së Republikës sonë.

Serbia e krimit dhe e gjenocidit nga ky aksion tinëzar dhe i pabesë kishte nxjerrë një mësim të mirë. Mësim se UÇK-ja po bëhej forcë serioze që po i rrezikonte seriozisht interesat e saj grabitqare dhe gjenocidare në Kosovë. Pasi rreth kësaj force çlirimtare po rreshtoheshin shqiptarët liridashës brenda e jashtë atdheut. Armiku, për t'i asgjësuar bërthamat e saj në Prekaz, Drenicë e Kosovë, nuk do të lente forcë e mjete pa përdorur për nënshtrimin e asgjësimit të saj. Dhe kjo nuk ishte hera e parë që në shekullin XX serbët pësonin disfatë në Prekaz, në Drenicë e Kosovë. Një disfatë tjetër e madhe po i priste pas një viti!

Lavdi Jasharëve legjendarë!  
Lavdi Adem Legjendarit!

## Kryetari Jashari: Sulmi i 22 janarit ishte paralajmërim që lufta do të fillojë shpejt



SKENDERAJ, 22 JANAR (ER) - Me rastin e 22-vjetorit të sulmit të dytë të forcave serbe mbi familjen Jashari, Komuna e Skenderajt, në bashkëpunim me Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në shenjë kujtimi e nderimi të luftës së shenjtë çlirimtare të familjes Jashari. Me këtë rast kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka deklaruar se 22 vjet më parë, pas syfyr, pasi që në atë kohë ishte muaji i Ramazanit, forcat serbe sulmuan tinëzisht familjen Jashari, ku mbeten të plagosura dy vajza nga familja

Jashari. "Fatkeqësisht atë natë komandanti Adem Jashari nuk ishte në shtëpi, por luftën e bënë gjyshi, babai im Hamza dhe anëtarët e tjerë të familjes që iu kundërpërgjigjen ashtu siç e merituan, ku pas 45 minutave sa zgjati sulmi, mbeten të plagosur shumë ushtarë serbë, lanë armatimin dhe ikën mbrapsht", ka thënë kryetari Jashari.

Ai ka theksuar se ky sulm ishte një paralajmërim që lufta do të fillojë shpejt.

Kryetari i OVL-së së UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se 22 vjet më parë në sulmin e dytë mbi familjen Jashari u plagosën dy vajza të kësaj

familje. "Kështu që ne sot kemi obligim dhe ndihemi krenarë me punën dhe veprën e tyre. Këto krisma të asaj kohe kanë qenë krisma të lirisë. Lavdi për jetë të gjithë dëshmorëve të kombit!", është shprehur Gucati.

Pjesë e ceremonisë së homazheve ishte edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili tha se bashkërisht po i kujtojmë këto ngjarje, siç është kjo e 22 janarit, para 22 vjetësh. "Vetëm një ditë pas këtij sulmi bashkë me bacën Rifat, vëllanë tim, Fehmiun,

me Lulzim, Muratin, kemi filluar në Tiranë organizimin e sjelljes së armatimit për Komandantin Legjendar Adem Jashari, por që komandanti ka rënë në krye të betejës, pa pasur fatin e marrjes së këtij armatimi", ka deklaruar Lladrovci.

Pjesë e ceremonisë së homazheve ishin edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, Klubi i Futbollit "Drenica" dhe qytetarë të tjerë të cilët kishin ardhur për ta nderuar jetën dhe veprën e familjes Jashari.





## Lluka hap konferencën 'Sjellja e përgjegjshme e biznesit në xehetari'

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Nën organizimin e Ambasadës Kanadeze në Kosovë, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka marrë pjesë në konferencën 'Sjellja e përgjegjshme e biznesit në xehetari', ku kanë marrë pjesë rreth 60 profesionistë nga sektori publik, privat dhe akademja. Gjatë hapjes së konferencës në fjalimin e tij, Lluka ka treguar se çka është

arritur në këtë sektor gjatë kohës sa ai ishte në krye të MZHE-së. "Pas më shumë se një dekade zonat me interes të veçantë janë hapur për investime strategjike. Gjatë kësaj periudhe kemi krijuar kornizë ligjore dhe rregullatorë për investime në sektorin minerar", u shpreh Lluka. Ai ka thënë se si ministër përgjegjës për sektorin minerar,

në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Qeverinë Kanadeze në vitin 2018 ka nënshkruar marrëveshjen për mbrojtjen e investimeve kanadeze në Kosovë dhe anasjelltas. Ai në fund ka falënderuar organizatorët e konferencës duke thënë se organizimet e tilla janë një hap i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit minerar.



# Tarifa prej 100 përqindësh nuk është shtylla e zhvillimit ekonomik në Kosovë

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 JANAR - Të mërkurën është mbajtur tryeza e diskutimit e organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës e cila pati për qëllim diskutimin mbi efektet e tarifës doganore prej 100 përqindësh ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, në ekonominë e vendit tonë.

Në fund të vitit 2018 qeveria ka miratuar vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që fillimisht t'u vendoset masa prej 10 përqindësh e pastaj prej 100 përqindësh ndaj dy shteteve, Serbisë e Bosnjës dhe Hercegovinës, tarifë kjo e cila erdhi si kundërpërgjigje për

agresivitetin e Serbisë ndaj Kosovës.

Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, ka thënë që Klubi ka bërë një analizë mbi efektet e tarifës nga të dhënat reale të marra nga Dogana e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës si dhe Banka Qendrore e Kosovës, për një periudhë mbi njëvjeçare, pasi që studimet e deritanishme tremujore nuk japin rezultatet e duhura. "Nuk i kemi analizuar aspektet politike, por vetëm ato ekonomike përgjatë analizës sonë. Ajo çka mund të përfundojmë është se ka impakt pozitiv nga tarifa dhe çka mund të konkludojmë është se Kosova mund të mbijetojë edhe pa Serbinë, të mbështetet në pro-

duktet e veta dhe me tregtinë me vendet mike të saj", ka thënë Panxha.

Fejzulla Mustafa, pronar i kompanisë "Fluidi", ka treguar që tarifa ka dhënë një efekt pozitiv te prodhuesit në përgjithësi, por edhe për kompaninë e tij. "Tek ne kemi pasur ngritje të shitjes së vajit 'Floil', i cili ka qenë i shumë i konkurrueshëm më parë nga disa vajra që vinin nga Serbia", është shprehur Mustafa. Ai ka kërkuar që të vazhdohet vetëdijesimi i konsumatorëve për konsumimin e produkteve vendore edhe pas tarifës. "Ne si prodhues nga Kosova jemi të bojkotuar nga konsumatorët serbë e jo vetëm nga shteti serb, prandaj kërkojmë edhe nga konsumatorët tanë

të kenë të njëjtin vetëdijesim", ka thënë ai.

Ndërkaq Gojart Kelmendi nga kompania "Flutra" ka treguar që, sipas të dhënave, sektori i përpunimit të letres ka shënuar rritje prej 25 përqindësh që nga tarifa. E kjo ngritje ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e punësimit. "Tarifa ka treguar që përpos që e kemi mbuluar tregun e vendit, e kemi rritur konkurrueshmërinë edhe për eksport", ka deklaruar Kelmendi, i cili ka kërkuar nga qeveria e ardhshme që të kenë kujdes me sektorin e prodhimit, i cili bartë barrën kryesore të punësimit dhe mirëqenies ekonomike të qytetarëve. Kurse ekonomisti Muhamet Mustafa u shpreh se rritja e qëndrueshme ekonomike e vendit

varet vetëm nga rritja e prodhimeve vendore. Ai ka thënë që taksa ka pasur efekte pozitive, ku ka përfituar buxheti i shtetit dhe shkalla e inflacionit ka qenë e vogël. Ai ka kërkuar që problemet politike të mos ndikojnë në zhvillimin e politikave ekonomike. "Efektet janë të rëndësishme dhe tregojnë që me politika aktive në mbështetjen e prodhuesve vendorë mund të shkojmë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova duhet të ndërtojë politika aktive për prodhuesit vendorë. Sot sektori i prodhimit është në konkurrencë të pabarabartë me importin", ka thënë ai. Po në këtë tryezë u prezantua edhe anketa e qytetarëve për konsumimin e prodhimeve vendore.



## Lulzim Rafuna emërohet ministër i Financave, Magbule Shkodra ministre e Zhvillimit Rajonal

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka emëruar të mërkurën Lulëzim Rafunën,

ministër në detyrë të Financave, ndërkaq Magbule Shkodrën, ministre e Zhvillimit Rajonal. Lulzim Rafuna deri më tani ka

ushtuar pozitën e këshilltarit të ish-ministrit Bedri Hamza. Rafuna para se të emërohej këshilltar ka qenë drejtor i

përgjithshëm i Doganës së Kosovës, kurse Magbule Shkodra ka qenë zëvendësiministre e Zhvillimit Rajonal.



## 'Jetimat e Ballkanit' dhe Komuna e Lipjanit dhurojnë 10 shtëpi për skamnorët

LIPJAN, 22 JANAR (ER) - Kryetari Komunes së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me drejtorin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", kanë bërë shpërndarjen e çelësave të 10 shtëpive që janë ndërtuar në territorin e Lipjanit për familjet në nevojë. Me këtë rast, kryetari Ahmeti ka thënë se ndihet mirë dhe mirënjohës ndaj Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" në krye

me Halil Kastratin që ka bërë një punë të shkëlqyeshme në Lipjan. Ndërsa Halil Kastrati është zotuar se edhe në vitin 2020 do të vazhdojë bashkëpunimi me Komunën e Lipjanit për t'u dalë në ndihmë familjeve skamnore. Ndërtimi i këtyre shtëpive është mundësuar nga bashkëfinancimi i Komunes së Lipjanit dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit".

## Komuna e Rahovecit bën shpërndarjen e fazës së pesë të mekanizmave bujqësorë

RAHOVEC, 22 JANAR (ER) - Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka bërë shpërndarjen e fazës së pesë të mekanizmave bujqësorë. Në këtë fillimvit, nga kjo fazë e shpërndarjes, 53 fermerë kanë përfituar mekanizma bujqësorë, të cilët përfshijnë: 53 pajisje: 10 freza me gjatësi 3 metër, 6 freza me gjatësi 1.8 metër, 5 freza me gjatësi 1.6 metër, dhe 32 mulqere të hardhive. Gjatë fazës tjetër

të shpërndarjes, e cila pritet të bëhet në fillim të muajit shkurt, do të shpërndahen motokultivatorë. "Bujqësia ishte dhe mbetet prioriteti ynë, si një ndër sektorët kryesor të cilët kontribuojnë dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj përkrahja e fermerëve është e një rëndësie të veçantë. Urime të gjithë përfituesve! I gëzofshi dhe ju shtofshin prodhimet tuaja kualitative", ka thënë kryetari i kësaj komune, Smajl Latifi.



## Të rinjtë nga Anamorava do të trajnohen për tregun e punës



KAMENICË, 21 JANAR (ER) - Qendra Rinore Gjilan (QRGj), në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kamenicë ka filluar implementimin e projektit "Fuqizimi i kompetencave të të rinjve në përgatitjen për tregun e punës".

Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se ky projekt ka për qëllim

zhvillimin e mëtutjeshëm të aftësive të buta të studentëve në nivelin universitar (18-24 vjeç) në rajonin e Anamoravës, më specifikisht në Komunën e Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë, si dhe përgatitjen e tyre që të mund të operojnë në tregun e punës në mënyrë të suksesshme dhe efektive. "Në kuadër të këtij projekti do të realizohet trajnimi katërditor

me temë 'Shkathtësitë e buta, çelës i përgatitjes për tregun e punës', prej datës 13 - 16 shkurt 2020. Ky trajnim do të përmbajë katër module: komunikimi, aktivizmi qytetar, shkathtësi punësimi dhe puna në grupe. Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit certifikohen për pjesëmarrjen e suksesshme në trajnim", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

## 3 584 kërkesa të qytetarëve shqyrtohen nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

Deçan, 22 janar (ER) - Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Deçanit brenda vitit 2019 ka shqyrtuar 3 584 kërkesa të natyrave të ndryshme. Lajmin e ka bërë me dije drejtori i kësaj drejtorie, Agron Muslija. Ai ka thënë se

drejtoria që drejton është efikase ku, sipas tij, brenda afatave kohore përfundojmë të gjitha lëndët të cilat vijnë si kërkesë e qytetarëve të Komunës së Deçanit. "Të përfundohen të gjitha këto kërkesa do të thotë se duhet të jesh i gat-

shëm të përballësh me specifika dhe secilës kërkesë veç e veç duke iu përshtatur edhe afatit kohor. Por, falë gatishmërisë së këtij dikasteri ne kemi arritur që me përpikëri t'i kryejmë detyrat tona karshi qytetarëve", ka thënë ai.



## Hoti shpërndan libra për 236 nxënës të Vushtrrisë

VUSHTRRI, 22 JANAR (ER) - 236 nxënës të Komunës së Vushtrrisë janë shpërblyer nga një set me libra në kuadër të Programit Nacional për Rininë. Këto shpërblime atë i kanë marrë si fitues të garës

Nacionale të Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik dhe garës Nacionale të Diturisë. Librat për këta nxënës i ka shpërndarë të mërkurën koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe

Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti. Ai gjatë ceremonisë së ndarjes së shpërblimeve u ka thënë nxënësve se përmes leximit ata do të jenë të barabartë me fëmijët e tjerë në botë.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (8)

# Ligji i energjisë magnetike



Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan

Në rrethana të caktuara energjia e fushës magnetike të një magneti rritet kur vihet në kontakt me materiale feromagnetike, kurse një pjesë e kësaj energjie transformohet në energjinë e fushës antimagnetike.

Argument i pakontestueshëm Krijimi i fushës magnetike të tokës nga fenomeni i tornados elektromagnetike tashmë është shpjeguar ("Epoka e re", 2019). Po ashtu është argumentuar se në momentin kur mbi polet magnetike të tokës është krijuar shtresa e materialeve feromagnetike, kjo ka ndikuar në rritjen e energjisë së fushës magnetike brenda poleve magnetike të tokës, e cila fushë magnetike transformohet në fushën antimagnetike simetrike, e cila për dallim nga fusha magnetike që buron nga polet magnetike, fusha antimagnetike buron nga pjesa anësore e magnetit të tokës. Këtu duhet shtuar se të dyja këto energji të të dyja këtyre fushave shndërrohen në punë. Kjo punë shpenzohet për mbrojtjen e tokës nga goditjet e ndryshme.

## Puna e energjisë së fushave magnetike dhe antimagnetike të tokës

Shumë kërkime, për mos të thënë të gjithat, gjithandej në glob janë orientuar në gjetjen e kësaj pune diku në univers. Por, e vërteta është se kjo punë buron nga përfundi këmbëve tona, kalon nëpër duart tona, ngritët në kokat tona, e shohin e nuk e vërejnë.

Prandaj, bazuar në rezultatet e pa kontestueshme eksperimentale të eksperimentit numër dy të botuar në "Epoka e re" 2019, mund të thuhet se emëruet i përbashkët i rritjes së kësaj energjie të fushave brenda këtij sistemi është vetërigjenerimi i fushave të magnetit. Kjo mbase mund të tingëllojë si formulim heretik, pasi që vetërigjenerimi për shkencat e natyrës është një mollë e ndaluar. Mirëpo, këtë ndalesë e ka vendosur jo natyra po njeriu. Ndaleja ka ardhur si pasojë e njohjes gjysmake të

fenomeneve të natyrës, mundet edhe nga një konsultim i mangët me natyrën apo nga të kuptuarit e ngushtë të natyrës. Sepse, natyra, me një gjuhë tjetër, po i tregon shkencës se vetërigjenerimi ekziston.

## Origjina e rigjenerimit të fushës magnetike

Pasi fusha magnetike buron kryesisht nga materialet feromagnetike, të cilat përbëhen nga atomet, kurse atomet përbëhen nga protonet, neutronet dhe elektronet. Duke u bazuar në argumentin eksperimental se rritja e energjisë së fushave magnetike dhe antimagnetike brenda një sistemi të izoluar është tregues i qartë i vetërigjenerimit të fushës magnetike. Këtë vetërigjenerim e shkakton prezenca e materialeve feromagnetike mbi polet e magnetit. Kurse pasi të gjitha elementet e sistemit periodik duke përfshi edhe materialet feromagnetike përbëhen nga atomet, atëherë themi se zgjidhja e këtij problemi orientohet nga struktura e atomit. Kurse në aspektin shkencorë kjo troket në dyert e strukturës së atomit, një strukturë tejet e pakompletuar në kuptimin shkencor, pa marrë parasysh shumë rezultate që mendohet se janë arritur në këtë drejtim.

Prandaj edhe vetërigjenerimi i fushës magnetike e ka origjinën nga atomet e këtyre elementeve feromagnetike. Kështu që në aspektin shkencorë rigjenerimi i fushës magnetike do të thotë rigjenerim i atomeve të materialeve feromagnetike, por pasi atomet përbëhen nga protonet, elektronet dhe neutronet kjo nënkupton se kemi një vetërigjenerim të protonëve, neutronëve dhe elektroneve të këto materiale.

Edhe pse vetërigjenerimi është i pakontestueshëm, jo gjithëherë atomet e njëjta kthehen në vetërigjeneratorë. Në këtë

mënyrë themi se atomet e materialeve feromagnetike siç janë: hekuri (Fe), nikeli (Ni) dhe kobalti (Co) në kondita të caktuara kanë aftësi vetërigjenerimi. Prandaj prapë se prapë themi se vetërigjenerimi i të gjitha llojeve të atomeve, duke përfshi edhe atomet e lartë përmendura është në kundërshtim me ligjet e fizikës dhe ligjet e kimisë. Këto dy shtylla të shkencës duke mos përjashtuar edhe lëmi të tjera shkencore i njohin këto atome të parigjenerueshme, pa marrë këto atome të materialeve feromagnetike për shkencën e tanishme, mendohet se njihen shumë mirë, sepse pretendohet se tregohet saktë se sa është numri i protoneve, elektroneve dhe neutroneve brenda një atomi.

Kuptohet se këto të dhëna janë të njohura për shkencën mbi numrin e protoneve, elektroneve dhe neutroneve brenda materialeve feromagnetike. Madje sipas shkencës ky numër i protoneve, elektroneve dhe neutroneve të këto elemente mbetet i pa ndryshuar pa marrë parasysh nëpër cilat kondita kalojnë këto atome.

Kjo kuptohet farë thjeshtë mjafton që ta shohim strukturën e atomit të cilën e njeh shkencën sot dhe rezultatin e kemi të gatshëm. Sepse struktura e atomit e cila njihet shkencërisht nuk ka ndonjë formë brenda atomit që do ta lejon një vetërigjenerim të këtyre grimcave elementare. Përkatesisht qoftë protonet, elektronet apo neutronet sipas shkencës nuk kanë në brendësi të tyre një mekanizëm që do t'i transformonte në vetërigjenerator të grimcave të njëjta.

Vetërigjenerimit ia mbyllë rrugën edhe prezenca e kuarkeve në brendësi të protonëve, elektroneve dhe neutroneve, të cilave ju mungon një mekanizëm që do ta argumentonte mënyrën e ngarkimit të

këtyre grimcave qoftë me ngarkesa pozitive siç është protoni apo ngarkesa negative siç është elektroni.

Por ndryshe nga shkencën e tanishme e cila atomin e njeh si një grimcë e cila nuk ka mundësi të shndërrohet në një grimcë vetërigjeneruese, unë si zbulues i fushës antielektrostatike pjesërisht në botimet e vitit 2016 dhe më gjerësisht në botimet e vitit 2019 në "Epoka e re", për të qenë këto grimca funksionale dhe të kenë një lidhshmëri me natyrën kam sjell ndryshime në strukturën e brendshme të atomit.

Në këto botime janë bazat e një strukture të re të atomit, e cila nuk i përjashton edhe disa mikrogramca që shkaktojnë fenomene në strukturën e brendshme të protoneve, elektroneve dhe neutroneve. Në këtë mënyrë e paraqesim një shkëputje nga këto botime të 2019 në "Epoka e re" mbi strukturën e atomit, theksohet shumë saktë se: a) Protoni është një grimcë e ngarkuar me elektricitet pozitiv dhe përbëhet zakonisht nga dy kuarke (quarks) lart (up) dhe një kuarki (quarks) poshtë (down). (2/3u) lart (up), (2/3u) lart (up) dhe (-1/3d) poshtë (down) kurse b) Elektroni është një grimcë e ngarkuar me elektricitet negativ dhe për dallim nga protoni elektroni përbëhet zakonisht nga dy kuarke negative (quarks) poshtë (down) dhe një kuarki pozitiv (quarks) lart (up). (-2/3d) poshtë (down), (-2/3d) poshtë (down) dhe (-1/3d) lart (up) dhe e treta c) Neutroni është një grimcë elementare pa ngarkese elektrike.

Përbëhet nga tri kuarke një kuarki pozitiv (2/3u) (up) dhe dy kuarke negative (-1/3d) dhe (-1/3d).



Këto kuarke njihen edhe nga fizika e tanishme, por asnjëherë nuk e zgjedhin problemin me të cilin në ballafaqohemi, sepse

shkencën i konsideron këto kuarke sikur statike. Fjala statike në këtë rast ka domethënie se kuarkeve ju mungon një motor që i vënë në lëvizje për ta argumentuar ngarkesën elektrike të tyre.

Problemi kryesor është se nuk është sqaruar asnjëherë se cila është ajo forcë lëvizëse që e bën ngarkimin e protoneve dhe elektroneve brenda atomit me ngarkesa të tilla pozitive dhe negative. Kështu që kuarkeve nuk kanë asnjë logjikë shkencore nëse janë statike. Pastaj asnjëherë nuk është qartësuar se pse elektroni nuk përplaslet me bërthamën e atomit, pasi fizika e njeh vetëm forcat tërheqëse brenda tyre por jo edhe forcat shtytëse, por asnjëherë nuk është sqaruar se pse neutroni rrinë më afër protonit se elektronit.

Gjithashtu dihet se masa e elektronit është afërsisht rreth 1835 herë më e vogël se e protonit dhe neutronit, kurse ngarkesa elektrike është e njëjtë.

Kjo formë e ngarkesës nuk përputhet së pari me natyrën, sepse po ta krahasojmë me se cilin do trup që rrotullohet rreth diellit, shihet se energjia e fushës magnetike është më e vogël se sa energjia e fushës magnetike të diellit. Por edhe masat e tyre janë më të vogla. E gjithë kjo kishte të bënte me gjendjen e protoneve, elektroneve dhe neutroneve në gjendje të lirë, por nuk përjashtohet edhe mundësia që ky nivel i ngarkesave përmes një shkakut të veçantë të arrihet i njëjti nivel i ngarkesave elektrike të protonet dhe elektronet. Por për këtë duhet kuptuar edhe më tej brendësinë e tyre. Prandaj një forcë tërheqëse në mes këtyre grimcave pa një forcë shtytëse nuk i japë një kuptim të qartë, se si mbahet stabiliteti i atomit pasi kjo forcë tërheqëse atomin do ta kthente në një grimcë inegzistente ashtu sikur mendohet sot. (VIJON)





# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)



# “Vallja shqiptare” e Kadaresë – Gjuhë, muzikë, lëvizje... një magji e përkryer

**Nga Dr. Riza BRAHOLLI**

Ky shkrim e ka zanafillën kohë më parë, gjatë një ore mësimi. E kisha lexuar herë pas here këtë poezi dhe kishte mbetur brenda meje si një gjë me shije të mirë e pikante; imazhet tejet origjinale, thellësia e mendimit dhe mesazhi që përçon, më kishin lënë një dritë të bukur dhe një qasje monumentale. Tash vonë, në një nga ditët e kësaj vjeshte, duke pirë kafe me një nga miqtë e mi më të dashur, me poetin Petrit Ruka, po bisedonim rreth poezisë, folklorit dhe rreth poetëve e krijuesve që kanë hapur hulli e kanë lënë gjurmë të thella me lëvrimin e tyre të shkrimit shqip.

E nëse bëhet fjalë për letërsinë e sotme shqipe, nuk ka si të mos shkojë fjala te kontributi estetik-poetik i Ismail Kadaresë. Mes llojeve të shumta të komunikimit, më erdhi befaz gjuha e shënjimit të lëvizjeve. “Vallja shqiptare” e Ismail Kadaresë m’u shfaq me imazhet e saj në çast e më erdhi kaq e qartë e plot dritë; secili detaj e imazh më hapi një dritare për të folur rreth valles, shenjave, marrëdhënieve të saj me

muzikën, shënjimin e një bote në erë, nevojën njerëzore për të shprehur nëpërmjet kësaj gjuhe atë marrëdhënie që ndodh midis trupit e shpirtit, midis tokës dhe qiellit; diçka që është e prekshme nga syri, e perceptueshme nga mendja dhe e ndjerë nga zemra. Arti i ngritur mbi vallen më kishte dhënë kështu një tempo më shumë në ligjërimin tim.

Pse? Mbase, sepse vetë poezia i dha ligjërimin tim përjetim e pamje të pashlyeshme, që më vinin edhe nga fëmijëria. Që sa e mbaj mend këtë botë, vallja ka qenë bashkudhëtarja ime. E kam parë si hiqej, hidhej e dridhej nëpër dasma, festa apo skena; si mrekulloheshin njerëzit e si përfshiheshin në të, duke harruar ku ishin e kush ishin: rangun, shtresën, radhën, racën apo gjininë. Ritmet dhe lëvizjet e tyre i çonin njerëzit në një tjetër hapësirë, në një tjetër mendësi, ndjesi sociale e demokratike, që t’i iknin realitetit të përditshëm. Më kujtohet Devolliçja magjike, valltarët e veshur me takije, xhamadanë të qëndisur, këmisha të bardha, fustanella e opinga me xhufka. Hynin në skenë të lehtë si ajri, duke tundur shamitë në erë. Fillonte muzika

dhe opingat e tyre, me ato zjarret e kuqe të vogla mbi to, trokisinin lehtë, sikur nuk i mbante dheu, e donin të nisheshin. Në fillim rrëshqisnin me majat e gishtave, centimetër për centimetër, pastaj me hapa të vegjël, e pastaj mbi thembra mbi dyshtet apo lëndinën ku hiqej vallja, mbështetur mbi gjokset e supet e njëri-tjetrit me krahët e lidhur, sikur të donin të pushtonin tokën, hapësirën, kohën: ngadalë, të vendosur e të sigurt, derisa ajo kthehej në një vrundull energjie të papërmbajtur, një qerthull ere e çuditshme që dilte nga shpirtrat e atyre burrave të dalldisur pas muzikës e lëvizjes, në një tjetër kohë, në një tjetër hapësirë përjetimi: valltarët ngriheshin drejt tavanit, më saktë, drejt qiellit dhe e godisnin me kokë apo i jepnin dyshtesë një të goditur me thembrën e këmbës, sa tundej krejt shtëpia, si për të thënë se dhoma ishte e ngushtë, e vogël dhe donin t’i thyenin muret, tavanet, dyshtet dhe marrëdhënia e tyre duhet të ishte me tokën, me qiellin. Në lëndina ishte ndryshe, vëmendjen e merrte shamia që tundej në erë sipas ritmit; mua më dukej sikur në dorë mbanin

një copëz reje të bardhë, që lëkundej nga juga midis qiellit të kaltër. Dhe, të jem i drejtë, me xhelozinë e të qenit bir i asaj treve, ku kërcehej e luhej ajo valle, ma donte zemra që Kadareja ta kishte marrë flakën e krijimit të kësaj poezie atje, prej saj, prej Devolliçes apo Gorarçes, që janë gati e njëjta valle, por me rifinitura të veçanta të lëvizjeve; tek ato xhufka të kuqe mbi opinga që kisha parë edhe unë, që seç më ndiznin ca zjarre adhurimi e mitizimi në zemër.

Megjithatë, sapo çlirohesh nga hapësira e ngushtë, përjetimi shkon më tej e më përtej fushave, kodrave e maleve, lëndinave e livadheve të këtyre trojeve, në festat pagane e ato fetare, në dasmat e në sheshet e luftës, para e pas saj; që nga vallja e Osman Takës apo vallet e Labërisë, vallja e Librazhdit, Myzeqarja, e Kolonjës, apo Dardharja me finesën e kërcimit të grave veshur me kostumet kuqezi e deri te vallet e skajeve më veriore të etnisë sonë: Rugovarja, Vallja e Tropojës, e Kukësit, e Dibrës apo Vallja e Shpatave. E më përtej këtyre, vallja kthehet në një simbol të fuqishëm shprehjeje e komu-

nikimi artistik të paimagjinueshëm. Gjuha e saj, nëpërmjet kodifikimit të këtyre lëvizjeve përmes muzikës dhe shpesh e shtuar në vlera edhe me peshën e fjalës, shenjave në erë apo në sinjalet që i jep tokës dhe njerëzve përreth, bëhet menjëherë e perceptueshme dhe e asimilueshme, deri në atë shkallë, sa nxit dëshirën për t’u përfshirë në të, në atë vorbull të një realiteti tjetër, që e jep vetëm arti i valles, drejt një lumturie, shprehje dashurie, ëndërrimi, guximi apo trimërie.

Sa herë e lexoj këtë poezi më habit thjeshtësia dhe madhështia e fillimit të saj; më duket kaq tokësor dhe njëherësh aq i pazëvendësueshëm vargu i saj i parë: Tri herë opinga rrahu dheun... Ka muzikë aty, pezulli, heshtje para gjëmimit; një uverturë e tërë mund të ngjizet e të luhet me të. Të sjell ndër mend një stuhi që pritet të fillojë pas kësaj qetësie, që prishet nga tri trokitje që fshehin e mbartin në vete gjëmime e vetëtima. Kështu je i detyruar të hapësh, jo vetëm veshët, por krejt kraharorin, krejt qenien, për ta shijuar, për ta përballuar e për ta festuar atë që do të vijë. Nuk është një shenjë

dokudo, por një sinjal që e animon dheun, një komunikim me tokën, me Perëndinë e lashtë, mbase, me më të lashtën, me Gjean. Pra, troket në derën e Perëndisë... Sikur kërkoi leje prej tij. Ç'lajm do të japë e ç'lajm do të marrë? Marrëdhënia, njëherësh, shndërrohet në një marrëdhënie kozmike e mistike të qenies me botën. Mesazhi nuk është më aq i thjeshtë dhe komunikimi nuk është më vetëm njerëzor: është i gjithë universi, e gjithë plotësia që merr pjesë në këtë marrëdhënie dhe shkëmbim të mesazheve mes tyre me një pafundësi interpretimesh. Dhe më pas: tri herë shamia palët ndeh... Po pse tri herë e jo katër, dy apo pesë? Edhe këmba, e zëvendësuar me opingën – duke na dhënë një metonimi të goditur – aq trokitje jep: tri herë opinga rrahu dheun. Simboli i treshit? Duket si interpretim i sfocuar, por nuk mund ta shmangim këtë simbol faktik e biblik, aq shumë të përdorur në poezinë botërore, sidomos kur vetë marrëdhënia që krijohet është metafizike, në kufijtë e abstraktes: marrëdhënia e përjetshme midis qiellit e dheut, tokës, apo trupit e shpirtit, që na sjell kështu në një përfundim të veçantë, siç është përzierja e të përjetuarit pagan me atë teik, duke i dhënë rëndësi e peshë asaj çka ndodh dhe jo filozofimit për të arritur në përfundime për to. Kështu kemi trinomin tokë-njeri-qiell. Pra, midis tokës dhe qiellit, njeriu, valltari që luan dhe që është mesazher midis tyre, që çon e merr lajme, një Hermes që e bën këtë botë të qenësishme e të njësishe me të gjitha shtresimet, valencat apo ngjirimet e saj. Por le të mbetemi te shamia që: ...palët ndehu/ me qetësi dhe madhësi. Me një ligjërim metonimik, ajo animohet si gjymtyrë e qenies njerëzore, një zgjatim i saj dhe simbol e shenjës, pikërisht, i lëvizjes. Madje të fokusimit te ky send që i tejkalon përmasat e qenësinë e një objekti të zakonshëm. Shamia gati kthehet në një shpend, në një Shqiponjë. Mjafton të zëvendësojmë palët ndehu me krahët ndehu, të shoqëruar me dy epitete epike: me qetësi dhe madhësi. Krahët mund t'i ndehë vetëm një shpend i madh; dhe nga të gjithë shpezët që njohim krahët mund t'i ndehë e shpalosë me qetësi dhe madhësi vetëm shqiponja. Vini re: jo, t'i hapë, por t'i ndehë, ku lëvizja përfundon me një pozicionim statik e të palëvizshëm në erë, në qiell, siç rëndom ndodh me këtë zog të fuqishëm e madhështor, që është edhe simboli i flamurit tonë. Kështu, ky element bëhet pjesë e një qenieje më shumë se njerëzore, e një vepruesi që është i ndërthurur dhe i pashkëputur nga elementet e sendet përreth, diçka që është send e ide, qenie e mesazh bashkë, duke e çuar përpara e duke e dimensionuar edhe me përfytyrimin, mendimin dhe idenë për atë çka

përfaqëson lëvizja, këmba, muzika, veshja, ngjyrat, mjetet, shpesh edhe fjalët me të cilat realizohet kjo marrëdhënie mistike e poetike; madje, të gjitha bashkë, si një shfaqje e plotë e unike e mesazhit poetik dhe estetik.

Pastaj poeti na çon në zanafillë: Kështu midis qiellit edhe botës/ Vallja u lind, vallja u shpall... dhe më tej na shpjegon edhe qëllimin dhe mesazhin e saj të madh, përse u lind dhe përse u shpall. Të bën përshtypje mënyra se si ai e jep këtë lajm: me një timbër të gëzuar që zakonisht jepet nga lindja e diçkaje të madhe, të paimagjinuar, fjala vjen, siç ndodh me lindjen dhe ngjalljen Krishtit: "Krishti u ngjall." Vallja u lind, vallja u shpall. Pra ajo lindet dhe shpallet, ashtu siç lindet dhe shpallet një mbretëri apo një kushtetutë, një kumt i madh; dhe lajmi kalon me shenja nëpërmjet syve e gojës së erës, vesh më vesh, fushë më fushë, mal më mal, siç kalojnë vetëm lajmet a kumtet e mëdha që ndryshojnë historitë.

Vallja, ky monument artistik njerëzor i gjithkohshëm, me një kod të gjithëkuptueshëm e gjithënjëzësor, ashtu si edhe muzika, përtej ndarjes së kombeve, erdhi si një mjet universal: Këmba sinjale i çon tokës/ Dhe dora qiellit i jep lajm. Pra, siç e thamë edhe më lart, valltari bën pikërisht atë që bëjnë profetët, mesazherët apo të dërguarit e mëdhenj të njerëzimit, marrin e japin, bëhen ndërlihdës të tokës me qiellin, kryejnë atë që filozofikisht quhet marrëdhënie midis tokësore dhe qiellore, midis materies e shpirtit. Mos është i fshehur dhe Dionisi aty? Mbase... edhe Dionisi edhe Apoloni. Sipas Niçes po: Apoloni nuk mund të jetonte pa Dionisin!

Pra, ajo që është materie dhe ajo që rrjedh prej materies e natyrës vetë e që quhet ideale, iluzion, ëndërr, shpirt. Kështu ndodh edhe me lëvizjet dhe ndjesitë që rrjedhin prej tyre. Kur njerëzimi filloi të hyjë në erën e moralit, një mënyrë për të fshehur lakuriqësinë e trupave dhe të veprimeve e ndjenjave ishte edhe nëpërmjet lëvizjeve dhe tingullit, si gjuhët më të gjithëkuptueshme, por edhe me kuptimet më të fshehuara.

Vështrimi kozmik e poetik i Kadaresë na e rrokullis vallen në kohëra sikur të ishte një gur hobeje në një hapësirë pa kahe: tutje, në një cak pafundësie, sa në gjenezën e lashtë, aq edhe drejt ardhmërisë, vetëm me dy vargje për nga fryma e përfytyrimit epik homerik: Dhe vallja rrokulliset tutje/ Në kohëra hedhur si hobe. Zhvendosja që u bën tablove, si për nga fuqia e krijimit ashtu edhe ajo e përfytyrimit, është me përmasa epike. Tërë historia e zhvillimit të valles është thukur, në mënyrën më të mundshme, vetëm në këto dy vargje. Me dy vargjet e tjera ai na jep një thelbësim të saj, gjithë epizmin, lirizmin e dramacitetin që mbart, në tërë kompleksitetin e tij, duke e metonimizuar sikur të ishte një qenie e perëndishme apo si një Hermes, lajmëtar mitologjik që fluturon në mënyrë të përhershme midis qiellit e tokës, për të përmbushur misionin e saj, duke mbartur edhe lulet e prillit, por edhe borërat e dimrave: Prilli përsipër i hedh lule,/ Dhjetori borën shkund atje. Ajo është mesazhiere dhe vetëm mbart mesazhe, tragjedi, dramë apo bubullima gëzimesh e finesa lumturie. Duket sikur na thotë se ky është fati i saj (valles), misioni i saj është epik e lirik dhe më shumë se historik, është historia

e vetë qenies njerëzore, por dhe e një etnie e kombi. Nëse tek tre strofat e para ai përqendrohet te simbolika e valles dhe çfarë ajo është në shumësinë e pafundësinë e universit e në marrëdhënien që ka me qenien e me botën, te dy strofat e fundit fokusi përqendrohet në mënyrë të posaçme te Vallja shqiptare:

*Valle shqiptare, shenja n'ërë  
Ylberë tirqesh tej-tëhu  
Kush ju kërcu ju njëherë  
Dhe këmbët rob s'i mbenë te ju?*

Këtu do të na duhet të ndalemi te një veçori e tërë veprës së Kadaresë, të fillit që e përshkon krejt veprën e tij, fillit historik e kombëtar. I dashuruar me atdheun e tij, në pamundësi të datave dhe fjalëve të shkruara, nga ato që quhen dokumente historike, me një grusht vlerash e të dhënash të nxjerra pikërisht nga folklori, nga këngët, vallet dhe duke marrë lëndën e tij e duke e kaluar nëpër enzimën e tij krijuese të pashoqe, ai gjakon dhe arrin të krijojë një Shqipëri ashtu siç e gjen në lëndën artistike të popullit: një Shqipëri të begatë arbërore, si te folklori ynë i arbëreshëve, ashtu siç ai e përfytyron dhe e ëndërron, pa ndryshkun osman dhe tjetërsimin kulturor e asimilues; jo që t'i shërbejë shkrimit të historisë, por ngulitjes së vetëdijes kombëtare në zemrat dhe mendjet e shqiptarëve. Kështu, pa pikën e drojës, na duhet të pohojmë se Kadareja kthehet në një mesazher e nuk e teproj nëse them një profet i ri e modern i shqiptarizmit, që filloi me Rilindjen Kombëtare. Shqiptari, kombi dhe liria janë tre elemente, tre dimensione të pandashme të një trupi apo qenësie që plotësojnë njëra-tjetrën në një tërësi tredimensionale, që në

veprën e tij shfaqet si një konvergim drejt një pike, te historia e qenësia e kombit shqiptar, me synimin e ngjizjes së mëtejshme të një ndërgjegjeje kombëtare, por me thelb modern. Në këtë vijimësi na duhet ta nënvizojmë edhe këtë krijim. Ajo është valle si gjithë simotrat e tjera në botë, por ai e sjell edhe me të veçantat e saj. Cilat janë karakterizimet që i bën? Shenja n'ërë dhe Ylberë tirqesh tej-tëhu. Vërejmë dy sintagma pa folje. Pra, nga ana stilistikore, shikojmë një ndërtim mungesor, që i jep dorë dendësimi të kuptimësisë e domethënies, përveç metonimisë që përdor për heqjen e valles: tej-tëhu. Tej-tëhu e kthen hapësirën në përmasa të papërcaktuara e të stërmëdha për një lëvizje valleje, duke e kthyer në një supervalle e, kështu, në një valle mbarëshqiptare. Pra, shohim përpjekjen e tij, deri në gjakim, për të shkruar dhe ngulitur në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve vlerat, qenësinë e historinë dhe kombit tonë. Mitizimi i valles, si vlerë shpirtërore e artistike, jepet thjesht, por duke mihur në krenarinë që e ruajnë pikërisht vallja apo kënga. Tek të dyja strofat ky mitizim i saj, me të gjitha vlerat që mbart, është i tërthortë e metonimik: Kush ju kërcu ju njëherë/ Dhe këmbët rob s'i mbenë te ju. Si te këto dy vargje dhe te dy vargjet e tjera: Kush ra midis vorbullës suaj/ Dhe s'u përzhit, dhe s'u përflak, ai e potencon shprehjen dhe i jep jetë e hapësirë qëllimit të tij, pikërisht duke na dhënë atë çka reflekton kjo gjë e shpirtëzuar si një magji e përkryer, që ne i shohim vetëm pasojat dhe prej tyre na duhet të ndërtojmë madhështinë e saj. Kjo vjen nëpërmjet një shtresimi figurativ, metaforik e metonimik, duke na dhënë analogji apo zëvendësim kuptimesh, si p.sh. pasojën për objektin: varësinë e këmbëve që janë të urdhëruara nga dëshirat e pasioni i magjisë që fsheh vallja; dhe zjarin, më saktë vorbullës së flakës, që përzhit e përflak si një perëndi zjarri. Dhe për ta mbyllur me një dyvargësh përsëri metaforik, të pakrahasueshëm për nga bukuria, epizmi dhe fuqia shprehëse që përcjell: Ju bubullima me opinga,/ Që nëpër shekuj bridhni varg, duke ia dhënë të gjithë ngarkesën kuptimore një pranëvëniesje të tillë të paimagjinueshme, siç është: bubullima me opinga, por që ia jep abstragimi i thellë dhe logjika koherente artistike e kuptimore e tërësisë ideore dhe poetike. Metonimia bubullima, që nënkupton valltarët apo vallet e tyre, plotësohet e rritet kuptimisht me metoniminë tjetër me opinga, që me mjetin për lëvizjen, zëvendëson kuptimisht hapat në valle, por, gjithashtu, me pranëvënien e tyre, duke na dhënë një sintagmë të plotë metonimike: bubullima me opinga që bredhin nëpër shekuj, kohëra, ashtu si vetë Kadareja, që nuk kërkon të ndalet në shekujt e afërt, por shkon thellë në histori, larg.../exlibris.al/





# E pamja – një institucion dhe protokoll i veçantë etnokulturor në Kosovë

## KODET E NGUSHËLLIMEVE NË KOSOVË

*E pamja* - pritja për ngushëllim kur vdes dikush në familje; shkuarja për kryeshëndoshë kur vdes dikush. *Shkoi në t'pame* - shkoi për kryeshëndoshë. E pamja në anë të Kosovës është pothuajse një institucion që i kushtohet shumë rëndësi. Në disa zona, në qytetin e Gjakovës përdoret *n't'pane*. E pamja dikur zgjaste shumë, më se një muaj; më vonë u thjeshtua në dhjetë ditë, e tani së voni mbahet kryesisht tri ditë. Kodete ngushëllimeve në Kosovë kanë një protokoll të vërtetë dhe mjaft të konservuar, e sidomos në Rrafshin e Dukagjinit. Ata që shkojnë për ngushëllime në një mort caktojnë prijësin, i cili zakonisht duhet të jetë me moshë më të vjetër, por dhe njeri që ia di rendin mirë protokollit për ngushëllime. Personi i caktuar komunikon me pritësin nga ana e familjes së të ndjerit për kryeshëndoshë apo, si thuhet, në Kosovë *në t'pame*, duke iu drejtuar atij dhe të pranishmëve të tjerë me fjalët:

*Burra, Zoti ju lashtë shnoshë! Mos u mërzitni!*  
*Burra, kush asht për kryeshnoshë, Zoti ju lashtë shnoshë! Edhe në emën të këtyre shokëve që janë me mu, Zoti ju lashtë shnoshë!* (ata të tjerët nuk flasin).  
Në përgjigje: *Kofsh shnoshë! Mërzi mos paçi!*  
Në vajtje për kryeshëndoshë, në Rrafshin e Dukagjinit, ai që shkon për të ngushëlluar nuk i pyet të pranishmit si jeni, e as pritësi nuk thotë mirë se erdhët! Nëse janë shumë veta në të pame, zoti i të pamës pyet mysafirët, zakonisht një ose dy veta: *"Shka jeni, çysh keni kalu rrugës?"* Kur kryhet ky muhabet, mysafiri (udhëheqësi i grupit) u thotë: *"Vazhdoni ku keni pasë renin"*. Zakonisht pritësit thonë: *Jo, s'kemi pasë diçka. Renin e ki ti!* (i jepet fjala mysafirit).  
Në raste të tilla flitet kryesisht për tema më të mëdha (p. sh., qysh po bëhet puna e Kosovës, për tema të tjera aktuale, jo për

çështje të rëndomta, ta zëmë si i keni bereqetet? Nuk marrin tema të zymta, të rënda, që përkujtojnë tragjedi familjare, që të mos u përtërihen dhembjet).

*Në t'pame* nuk rrihet shumë. Vende-vende, sidomos në anën e Rrafshit të Dukagjinit, vetëm shkohet sa për ngushëllime dhe nuk rrinë gjatë.

Tri lloj të pamesh janë:

*E pamja adet* - kur shkon e ngushëllon familjen, rri pesë minuta, siç është një lloj adeti, pra kryen një obligim formal.

*E pamja marifet* - kur shkon ta ngushëllosh familjen me kohë, me njerëz të duhur dhe lë një porosi a fjalë të mençur. Ato më pas edhe përmenden: siç ka thanë filani!

*E pamja adalet* - për faqe t'zezë, nuk e ngushëllon familjen si duhet, lë ndonjë fjalë që s'e ka vendin dhe familja e të vdekurit ndihet e fyer.

Kur shkohet *në t'pame* në Rrafshin e Dukagjinit, së pari ulja në odë është në gjunjë, në shenjë respekti për familjen për nderin e të vdekurit. Pastaj, pas fjalëve të para të zotit të t'pames, mysafiri pyet:

*"A u mërzitët!"* (nuk pyetet si jeni?).

Ngushëllimi i parë i shkon anëtarit të ngushtë të familjes së të ndjerit ose njeriut më të vjetër të atyre që presin: *"A u mërzitët për babën?"* Përgjigja: *"U mërzitëm kapak!"*

Mysafiri: *"N'emnin tem, edhe gjithë ktyne që janë me mu, Zoti ju lashtë shnoshë!"*

I zoti i të pamës: *"Zoti ju paftë e ju rujt!"* Atëherë i zoti i të pamës u thotë mysafirëve: *"Rahatohuni!"* (rrini lirshëm). Mysafirët ulen ashtu si u vjen më për mbarë, por pa i shtrirë këmbët, ulen këmbëkryq, në njërin gju (në odat tradicionale).

Në Rrafshin e Dukagjinit ka qenë traditë që kur kanë dalë prej t'panës njerëzit të mos u hipnin kuajve, por t'i tërhiqnin deri larg shtëpisë së të ndjerit, sepse hipja mbi kuaj është konsideruar si fyerje. Flitet se kur një mik shkon në të pame e gjen familjen e të ndjerit plot, me djem, me nipa, stërnipa, kushërinj, dhe ai sapo del nga dyert e oborrit menjëherë hip mbi kalë dhe vazhdon rrugën. Por mikut të tij i kishte mbetur hatri dhe është ndier i fyer. Pas disa ditësh kërkon shpjegim prej tij për këtë gjest. E ai i përgjigjet: *"Unë erdha për kryeshnoshë, për vdekjen e babës, por e pashë që*

*baba nuk kishte vdek, sepse e kishte lanë shpinë plot, prandaj i hipa kalit!"* (komunikim i Sylë Kasumajt - Dushkajë, Rrafshi i Dukagjinit).

Në Rrafshin e Dukagjinit, kryesisht, përveç elementeve të shumta etnografike që e karakterizojnë një ceremoni siç është vdekja (e pamja), interesant del edhe biseda që zhvillohet në mes të vizitorëve (miq, të afërm, etj.) që vijnë për ngushëllime dhe të zotit të shtëpisë. Në pjesën dërrmuese biseda zhvillohet përafërsisht si më poshtë, me pak dallime në të folme të ndryshme:

- *A mun dult burra?*

- *Dulem kadal, a po mun boni gajret?*

- *Po munohemi, s'kish njeri shka me ba?*

Në rastet kur i zoti i shtëpisë apo ai që është për kryeshëndoshë nuk e njeh prijësin e atij grupi, ai i drejtohet dikujt të njohur po nga ai grup:

*Nimom pak* (p. sh. Kolë/Hysen), a ndonjë emër tjetër.

Ai ia tregon emrin e prijësit të grupit, pastaj i zoti i shtëpisë i drejtohet:

- *Kolë, a mun dult?*

- *Dulem kadal, a po mërziteni ju?*



- Po mërzitemi kapak.

- Gajret/bonu t'fort/mos merziti (ka raste kur e fillon me Zoti ju lashtë shnoshë!), n'emnin tam e t'ktyne burrave që jemi, Zoti ju lashtë shnoshë!

- Kofshi shnoshë, ose mërzit mos paçi, ose Zoti u past e u rujt!

Pas këtij formaliteti, i zoti i shtëpisë apo dikush nga pritësit, që mund të ishte mik shtëpie, komshi etj., i drejtohet prijësit të grupit:

Nimona pak e zbutnani (hjeknani) ket merzi!

Kjo nënkupton që ai ose dikush nga grupi të fillojë të flasë diçka, ashtu si e kërkon rendi e vendi. Pas parashtrimit të kësaj kërkesë (ose dhënies së lejes) për pak kohë mbizotëron qetësi e plotë. Në këto rrethana prijësi i grupit zakonisht është njeri me përvojë dhe i përgatitur për raste të tilla, flet me kujdes, duke i përzgjedhur fjalët, si për nga ana shqiptimore (të jetë i qartë) ashtu edhe nga ajo kuptimore. Ai e fillon me një tregim (mesele) që e ka një mesazh dhe një kuptim të fshehur. Jo gjithkush e merr vesh, mund të jetë provokues, e që natyrisht pasohet nga një mesele tjetër si përgjigje nga pritësit. Por, ka raste kur ky tregim (mesele), është metaforik për t'u dhënë ngushëllim e kurajë familjes, si:

I zoti i shtëpisë: *folna dishka Shaban!*

Vizitori e nis zakonisht kështu: *Zoti u neroft' o burra, ose paçi faqen e bardh' (si shenjë falënderimi që po nderohet të flasë). Ish kon njani, burr i mir' e me zo. Nuk kish pas lon t'pame pa shku. Ish kan edhe i meçem, e kishin pas thirr edhe me nda pleqni. Ni dit e veti gruja, ku ke sod ti njeri, e ai ja kthej, kesh me ni dek t'ran bre gru.*

*Ni dit tjetër, gruja ja boni t'njetjen pytje, e ai ju pergjegj, kesh*

*me ni gjysë deke. Ajo po e vet opet, pse sod gjys deke o ti njeri e at dit the dek t'ron. Aj ja kthej: eee dek e ron se ish kon djali i ri e nuk kish lon kon mrapa, ju kish mshel dera me therr, e ku ka ma ron oj fisnike. Edhe ky sod ish kon i ri, e per familje boll dhimt e madhe, po shyqyr e kishin shpin' plot mashkuj, me djem e nipa, e per qita gjys deke se na ton deken e kemi hak (obligim). E nish (zaten), dhimta per ju o e madhe po shyqyr e kini plot shpin, e per qita e kini gjys deke, e Zoti ju lashtë shnosh!*

I zoti i shtëpisë apo dikush nga rrethi i ngushtë ia kthen: *T'lumt goja o mik (ose i drejtohet në emër). Ka raste kur tregimi i tillë pason me një nga pritësit, ose, me të përfunduar këtë, pas urimit të zotit të shtëpisë, udhëheqësi i vizitorëve e përsërit edhe një herë: Zoti ju lashtë shnosh dhe çohen (Naim Berisha, Leksiku dialektor i Rrafshit të Dukagjinit).*

Në Rrafshin e Kosovës, në Vushtrri me rrethina, zakonisht për 'kryeshnoshë' shkojnë në mënyrë të organizuar miqësia, shoqëria, apo familjarë të largët, apo edhe thjesht katundarët apo fqinjët, për t'i ngushëlluar për vdekjen. Kur të ulen mysafirët, zakonisht më i vjetri i pyet: *'Burra a muj duelt', apo 'a hiçt zamet me ardh', ndërsa ngushëlluesit thonë: 'A u mërzitit', 'mos u mërzitni, deka është prej Zoti', nëse ka vdekur më i vjetri në familja thonë: 'Mos u mërzitni, dekë me ren'. Është traditë që për shkak të numrit të madh të njerëzve, të mos të qëndrojnë më tepër se 5 minuta. Para se të ngrihen mysafirët thonë: 'Burra, mos u mërzitni', 'Zoti jua shtoftë sabrin (durimin) e gajretin', 'ishalla Zoti ka bo rahmet n'shpirtin e tij' dhe kërkojnë leje për t'u ngritur. Të*

pranishmit i falënderojnë për këtë gjest të tyre, duke u thënë: *'Zoti ju paft e u rujt', 'na keni nderu'. Kështu, përcillet e gjithë e pamja, duke pritur e përcjellë njerëz.*

E pamja organizohet veçmas te burrat, veçmas te gratë dhe ka karakter të fortë ceremonial edhe në zona të tjera të Kosovës. Te burrat caktohen ata që presin për kryeshnosh, të tjerët marrin vende përkatëse: disa më të vjetër qëndrojnë në dhomën e pritjes, kurse më të rinjtë presin në hyrje, në oborr, në paradhomë. I njëjti rregull është edhe te gratë. Edhe aty më të afërmit e të vdekurit qëndrojnë brenda, "rreth xhen?zes" (kufomës). Derisa te burrat ka atmosferë qetësie, te gratë përcillet me vaje dhe nëse i vdekurit është i ri, edhe me kuje.

Fjalët që thuhet te gratë janë të ndryshme, varësisht nga mosha dhe nga afërsia. Nënës për femijën i thuhet: *Mos u merzit, i paç tjet, t'i rujt zoti tjet!*; Motrës për vëllanë: *I paç tjet, exhelin aty e ka pas!* Ishalla nuk ju bjen me harru! Aktet më të rënda janë kur arrijnë të afërmit, bijat dhe kurbetçarët. Ata krijojnë atmosferë të dhimbshme dhe ndodh që vaji të përhapet te të gjithë të pranishmit.

Dita e tretë merret si dita më e ngjeshur për kryeshnoshë. Në rastet e vdekjeve të femrave të martuara, mbas ditës së tretë, hapet e pamja (vajtja për kryeshnoshë) edhe në familjen e prindërve. Si shprehje që e shoqëron gjithë këtë ceremoni përgjithësisht në Kosovë është: *Zoti ju lashtë sh?osh! Mos mërziteni, Zoti n'xhenet! Zoti n'xhenet ju perpjekt!*

Kur është vdekje e ndonjë plaku në atë lagje dëgjohe shprehja: *"Asht dek me ren".*

Kur shkohet për "kryeshnoshë"

caktohet prijësi, i cili i prin një grupi vëllezërisht, shokësh apo miqsh dhe ai e ka për detyrë komunikimin me familjarët e të vdekurit. Ai i drejtohet kryefamiljarit me shprehjen:

*O X, a jeni merzit?!*

Kryefamiljari ia kthen: *Jo shumë!* Ose nëse i vdekuri i përket moshës së re, kryefamiljari do t'i përgjigjet: *Po mërzitemi valla!*

Prijësi i grupit do të shtojë: *Mos u mërzitni, Zoti ju lashtë shënoshë!* Kryefamiljari ia kthen: *Zoti t'patë e t'rujt! Pastaj prijësi do të vazhdojë: Edhe në emen t'ktyne vllazneve (apo shokëve) ç'e erdha me ta, Zoti ju lashtë shnosh!* Ose nëse do të jenë vetëm dy veta do të thoshte: *Edhen'emen t'X, zoti ju lashtë sh?osh!* Pritësi ia kthen: *Zoti të ruajt ty dhe këta shokë.*

Treva e Kosovës është e pasur me fjalë ngushëlluese. Një formë tjetër e ngushëllimit është edhe shprehja: *shka jeni me gajret? Në disa vende edhe: shkajeni me saber?* Ndërsa i zoti i shtëpisë i përgjigjet duke thënë: *Po bájme!* Ndërsa ngushëlluesi ia kthen: *Zoti ju çoft gajretin!* E në disa raste: *Zoti ju çoft sabrin!* Kurse shqiptarët e besimit të krishterë e përdorin edhe formën: *Ju shnosh!* Brezi i vjetër i elementit mysliman përdor dëndur edhe shprehjen: *Zoti në xhenet ju perpjekt!* Për sa i përket brezit të ri, formave të vjetra të ngushëllimeve po ua zënë vendin shprehjet "moderne": *Ngushëllime!* Kjo ndoshta ndodh edhe për t'u dalluar nga brezi i vjetër, ose për të përfaqësuar një unitet kulturor.

Të pamën e përcjellin edhe biseda të cilat i shkojnë për shtat rastit. Ato bëhen për t'i dhënë lehtësi dhimbjes për të vdekurin, sidomos kur kemi të bëjmë me të vdekurin e moshës së re, apo për ndonjë njeri që ka

pasur të kaluar të bujshme, tregohen lloj - lloj rastesh. P. sh.:

1. *Shtatë të dekën e kanë rujt ni t'gjallë-një që â kon smut, shtatë vet e kanë rujt, ai është shërue e t'shtatit kanë dek para tina.*

2. *Deka s'ka yrnek: Ish kon njani e kish pas ni djalë për hasret. I kish hi tuta se do t'i diste djali, po ai thojke: ni ardh deka djalit tem, ishalla jo pi tri seneve: pi gjerpit, mu rrxu pi lisit dhe mu myt n'uj. U rrit djali e shkoi me xho. Breg ni prronit ish kon ni lis,. N'maje t'lisit ni strokëll. Hyp djali me mri vo to shenisë, e han xherpni e bjen pi llisit e n'uj. Pra deka s'ka yrnek.* Në rastet kur vdes ndonjë i sëmurë nga ndonjë sëmundje e rëndë (si kanceri apo paraliza) te gjinia femërore, në gjuhën e grave dëgjohe shprehja: *E paska kurtalis Zoti!*

Në ceremoninë e vdekjes sot në zonën e Rahovecit janë rralluar vajtimet, ndodh të dëgjohe ndonjë vajtim i rrallë kryesisht kur vdes ndonjë i ri apo e re. Në ato raste ngrihet lart kontributi i të vdekurit për familjen etj.: *E ka myll deren e shpis, mjer nâna për tâ, aj a kurtalis, po shka me ju ba t'xhallve etj.*

Në ditën e pestë është organizimi i t'shtatave. Të shtatave organizohen zakonisht pas ditës së tretë të varrimit. Mbas të shtatave mbyllet e pamja, por ajo mund të vazhdojë të jetë e hapur edhe më tutje për një rreth më të ngushtë.

Kur vdekja ndodh në mesin e shqiptarëve katolikë në disa pjesë ndryshon përmbajtja e fjalëve. Në vend të fjalëve me prejardhje orientale thuhet fjalë krejtësisht shqip. P. sh.: Në vend të selamalejkum, thuhet: *Ju ngjatjeta!* Mirëdita! Në vend të "Merhaba" thuhet: *Mirë se erdhe!* Rrini mirë etj. (Fridrik Dulaj). /Revista "Akademia"/



E rrallë

# Çiftet në radhë për një natë në shtëpinë e Romeos dhe Zhulietës

Darkë romantike nën dritën e qirinjve, shërbëtorë personalë dhe pamje mahnitëse nga balkoni në Verona. Të gjithë çiftet që duan të kalojnë një natë në shtëpinë e Romeos dhe Zhulietës tanimë kanë mundësinë ta jetojnë një përvojë të tillë falë kompanisë "Airbnb". "Casa di Giulietta" do t'i hapë dyert më 14 shkurt, Ditën e Shën Valentinit. Të gjithë të dashuruarit që do të donin të flinin në shtratin



historik, që është përdorur edhe në filmin e Franco Zeffirelli për Romeon dhe Zhulietën në vitet 1960, mund të aplikojnë duke ndarë historinë e romancës së tyre dhe të argumentojnë pse janë të ftuarit për destinacionin ikonik.

FOTO E DITES



Zogjtë shihen duke fluturuar mbi një varkë në lumin Yamuna në Nju Delhi në Indi. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Dhia me "fytyrë njeriu" shfaqet në Indi

Një dhi mutante po adhurohet si 'avatar i Zotit' pasi u lind me një fytyrë të sheshtë dhe me sy të çuditshëm si njeriu në Indi. Kafsha e re, e cila ka sy dhe gojë të ngjashëm me njerëz, lindi kohët e fundit në fshatin Nimodia në periferi të Jaipur, Rajasthan. Pronari Mukeshji Prajapap postoi një video të shkurtër të dhisë së zezë me një fytyrë



të çuditshme brenda kasolles së tij në fillim të kësaj jave.

## BARSOLETA E DITËS



- Nuk e kuptoj se si nuk ke të dashur!
- Nuk e di, çfarë të bëjmë...
- Po ti je yll i bukur more...
- Faleminderit!
- Do më tepër ushqim?
- Po, gjyshe.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



**DASHI**  
Mos mëkaton nga naiviteti në situatat që përballeni. Entuziazmi sot mund t'ju shtyjë t'i nënvlerësoni angazhimet.



**DEMI**  
Ju do ta keni mundësinë t'i rifillonit sërish disa situata pune, të cilat ditët e fundit nuk keni arritur t'i menaxhoni dot lehtë.



**BINJAKËT**  
Në çdo kontekst ju dini ta impononi veten me karizmin tuaj dhe me forcën e personalitetit tuaj që ju bën udhëheqës të natyrshëm.



**GAFORRJA**  
Do të jetë një ditë e komplikuar. Shpërqendrimi dhe përqendrimi i ulët do të jenë armiqtë tuaj më të këqij, veçanërisht nëse jeni të vetëpunësuar.



**LUANI**  
Idetë, në këtë moment, rrjedhin në mënyrë imagjinare dhe të vazhdueshme, por gjithashtu do ta keni mundësinë të keni saktësinë e nevojshme.



**VIRGJËRESHA**  
Super e zhgënjyer nga çifti Hënë-Uranus: gjithçka që keni mësuar, nga librat ose nga përvoja, tani do t'ju vijnë në ndihmë.



**PESHORJA**  
Hëna në shenjën e Bricjapit favorizon momentet e konfuzionit, duke nxitur perceptimin e një ndjenje të papërshtatshmerisë në situatat në të cilat e gjeni veten.



**AKREPI**  
Pushtime të lehta, provokimi është veshja juaj e fortë, por nëse zemra tashmë është e zënë, mos shkoni më tej: ndjenjat tuaja të fajit do t'ju sulmonin menjëherë!



**SHIGJETARI**  
Përpjekja për t'i realizuar projektet tuaja është e fortë, nuk ka vetëbesim. Shumë risi dalin në dritë për ata që kërkojnë dashuri.



**BRICJAPI**  
Në sektori sentimental, nëse jeni çift, por edhe nëse nuk jeni, do të keni një pozicion shumë të favorizuar. Ju dëshironi sigurime dhe shpërblime!



**UJORI**  
Duhet të mbyllni urgjentisht një iniciativë profesionale ose biznesi që filloi në një moment të pafavorshëm.



**PESHQIT**  
Kjo ditë hap një seri perspektivash në të gjitha frontet, duke filluar nga ajo profesionale.

## Mozzik dhe Tayna publikojnë këngën "Edhe ti"



**R**eperi Mozzik dhe reperja Tayna kanë publikuar para pak minutave këngën më të re. "Edhe ti"


është kënga së cilës teksti i është shkruar nga vetë reperët, ndërsa muzika është realizuar nga Cricket.

## Harry i bashkohet Meghanit në Kanada



**P**rinci britanik Harry ka arritur në Kanada për t'iu bashkuar gruas së vet, Meghanit dhe djalit të tyre, Archie. Ai fluturoi nga Londra në Vancouver ku doli nga aeroplani i shoqëruar nga sigurimet dhe u

fut në veturë. Para se të largohej nga Londra, princi pranoi se po merrte një "vetëbesim", pasi u tërhoq nga detyrat mbretërore në përpjekje për të ndërtuar një jetë më të qetë, pa kufizime mbretërore.



## Selena Gomezi, e lumtur për suksesin e albumit 'Rare'

**T**ashmë ka lansuar albumin e ri, të tretin me radhë, mirëpo sukseset e Selena Gomezit nuk kanë të ndalur edhe këtë fillimvit. Ajo tashmë ka zënë vendin e parë në tabelën "Billboard 200", sipas Neislen Music. Suksesin në tabelë erdhi menjëherë pasi këngëtarja dhe aktorja arriti ta

zë vendin e parë në tabelën e "Billboard Hot 100", me këngën "Lose You To Love Me", shkruan "Daily Mail". Triumfi i saj në tabelën e "Billboard 200" bazohet në periudhën javore (10-16 janar), ndërsa ky pozicion bazohet në kombinimin e shitjeve të albumit me atë të transmetimit.

## Çfarë sakrifice bëri Jennifer Anistoni që fustani që e veshi në SAG të mos rrudhej

**J**ennifer Anistoni pa dyshim se shkëlqeu me veshjen në tapetin e kuq në SAG Awards 2020. Por, kjo nuk ishte një gjë e lehtë për t'u bërë. Aktorja e "Morning Show" kishte veshur një fustan vintage (të stilit të vjetër) me material

mëndafshi dhe ngjyrë të bardhë të markës "Dior" nga John Galliano. Por, në mënyrë që ky fustan delikat të mos rrudhej para se ajo të arrinte në tapetin e kuq, Aniston u detyrua që të shtrihej në ulëset e prapme të veturës së saj.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Ad: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Klubet elitare të Kosovës tregojnë forcën në miqësore

Prishtina dhe Gjilani kanë fituar në miqësoret ndaj skuadrave të huaja, kurse Drita ka shkëlqyer ndaj Dardanës. Llapi e mposhti Partizanin "B" dhe në këtë mënyrë regjistroi fitoren e dytë në miqësore. Klubet po vazhdojnë intensivisht përgatitjet për pranverë dhe në ditët e ardhshme pritet të zhvillojnë ndeshje miqësore

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 22 JANAR** - Klubet e Superligës së Kosovës në futboll, Prishtina, Gjilani, Drita dhe Llapi, kanë shënuar fitore në ndeshjet miqësore të zhvilluara të mërkurën. Klubi më i madh i Kosovës që synim e ka triumfin në kampionat dhe garën e Kupës, Prishtina, ka treguar forcën e saj në miqësoren ndaj skuadrës bullgare, Arda (5-0), e cila u zhvillua në Antalia të Turqisë. Sulmuesi Ahmed Januzi shënoi dy gola në pjesën e dytë, kurse transferimi i ri i Prishtinës në këtë afat kalimtar, Otto John, shtoi dy gola të tjerë në pjesën e dytë, derisa një gol e ka shënuar edhe Hila. Fitore në Antalia ka shënuar edhe skuadra e Gjilanit, e cila e ka realizuar edhe fitoren e dytë në kuadër të fazës përgatitore në Turqi. Skuadra e drejtuar nga Gentian Mezani e mposhti skuadrën ruse Yenisey Krasnyarsk (1-0). Golin e fitores për skuadrën e Gjilanit e shënoi Darko Nikaq në "Emirhan Football Center". Klubi kosovar, përveç fitores, ka dominuar edhe me posedim të topit dhe me rastet e krijuara. Duhet cekur se në këtë ndeshje nuk munguan as tensionet ku klubi rus fillimisht e kishte cekur skuadrën e Gjilanit si klub nga Serbia, por pas reagimit të zyrtarëve të kësaj skuadre, janë bërë ndryshimet dhe është vendosur emri i Kosovës. "Gjatë transmetimit të ndeshjes zyrtare të klubit rus e kishin etiketuar në kanalën e tyre në 'Youtube', Gjilanin si klub nga Serbia. Në marrëveshjen e ndeshjes të nënshkruar nga zyrtarë nga dy skuadrat, figurojnë vendet e origjinës së skuadrave të pranuar për zhvillimin e saj, nga ku skuadra e Gjilanit mjaft qartë figuron si ekip nga Kosova dhe ekipi rus kishte pranuar zhvillimin e takimit. Pas reagimit të zyrtarëve të klubit të Gjilanit, nga ku dhe u shqyrtua mundësia e ndërprerjes së takimit, zyrtarë të klubit të Yenisey e përmirësuan gabimin e bërë gjatë transmetimit, duke e ndërruar vendin e origjinës së klubit tonë dhe pastaj figuroi Kosova", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Një fitore në ndeshje miqësore ka

regjistruar të mërkurën edhe skuadra e Tahir Batatinës, Llapi. Kjo e fundit e mposhti 1-3 Partizani "B". Një gol i realizuar nga Ersil Ymeri në pjesën e parë dhe dy në pjesën e dytë nga Arbnor Ramadani dhe Mentor Zhdrella ishin të mjaftueshme për fitoren e skuadrës nga Podujeva në përballje me skuadrën nga Shqipëria. Një miqësore më të lehtë e kishte skuadra e Dritës, e cila luajti ndaj rivalëve të Dardanës dhe arriti fitore të lehtë 7-2. Në pjesën e parë u shënuan shtatë golat për skuadrën e Atdhe Nuhiut, ku vlen të ceket se Betim Haxhimusa tregoi formë të lartë duke shënuar tre gola, kurse nga një e shtuan Erjon Vucaj, Hamdi Namani, Ardian Limani dhe transferimi i ri Almir Ajzeraj. Këto klube dhe klubet e tjera janë duke zhvilluar fazë intensive përgatitore për sezonin pranveror, i cili pritet të jetë jashtëzakonisht i fortë për faktin se disa skuadra po luftojnë për titull, derisa edhe lufta për mbijetesë është shumë e fortë, ku direkt nga Superliga largohen katër klubet e fundit.

## SHKURT

### Kosova U17 mposhti Maqedoninë e Veriut

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll ka shënuar fitore kundër Maqedonisë së Veriut në ndeshjen për plasman përfundimtar në kuadër të turneut "Mercedes Benz Aegean Cup International Youth Tournament" në Izmir. Ndeshja në kohën e rregullt u mbyll baras 2-2, ku golat për Kosovën i realizoi Luis Hoti, derisa në serinë e penalltive "dardanët" e rinj ishin më efikas se fqinjët e tyre, duke triumfuar 6-4. Kësisoj, Kosova u rendit e shtata, derisa këtë turne prestigjioz e fitoi vendi nikoqir, Turqia, që në finale e mundi Republikën e Koresë, me rezultat 2-1.

### Dushku: Nuk është shkarkuar Kurshumlja

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, e ka mohuar lajmin për shkarkimin e komisarit të garave në Federatën e Basketbollit të Kosovës, Faton Kurshumlja. "Nuk është e vërtetë që kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës e ka shkarkuar Faton Kurshumlin", ka thënë Dushku për "KosovaPress".

### Dukagjini prezanton Doshlakun

Mbrojtësi i njohur në futbollin e Kosovës, Lulzim Dushlaku, është prezantuar në skuadrën e Dukagjinit nga Klina. "Mbrojtësi i krahut, Lulzim Doshlaku, me një përvojë të madhe në futbollin e Kosovës vjen nga Klubi i Feronikelit, pjesë e secilës ishte për shumë vite. Ne i urojmë mirëseardhje në klubin tonë, gjithashtu i dëshirojmë shëndet e shumë sukses gjatë kohës sa është pjesë e jona", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

### Humbin Donjeta Sadiku dhe Shpëtim Bajoku

Boksierja Donjeta Sadiku ka pësuar humbje nga italianja Mesiano Alessia. Kjo humbje ka ardhur si pasojë e lëndimit që ka Sadiku, e cila, edhe përkundër kërkesës së trajnerit Besim Brahimi, vendosi të hyjë në ring. "Donjeta e humbi këtë duel pasi nuk mundi të japë as 50-përqindëshin nga vetja. Selektori Besim Brahimi nuk deshi që ajo të futet në ring, por Donjeta këmbënguli dhe u paraqiti, por që nuk ishte në gjendje ta tregojë atë shpirtin luftarak", ka thënë sekretari i Federatës së Boksit të Kosovës, Latif Demolli. Ashtu sikurse Donjeta Sadiku, humbje të mërkurën ka pësuar edhe boksieri Shpëtim Bajoku (63 kg) në turnen ndërkombëtar "Strandja" në Sofie të Bullgarisë. Bajoku u mundua të luftojë me të gjitha forcat, por kjo ishte e pamjaftueshme ndaj irlandezit me përvojë të madhe, Bates George, i cili fitoi me rezultat 4-1.

## Xhaka: Heshtëm kritikët, treguam se kemi karakter

LONDËR, 22 JANAR - Futbollisti shqiptar Granit Xhaka beson se Arsenali i ka heshtëm kritikët që thonë se "topçinjve" u mungon karakteri, të cilën beson se e dëshmuam në barazimin kundër Chelsea (2-2). Edhe pse me karton të

kuq nga pjesa e parë, pas përjashtimit të David Luizit në minutën e 22-të, Arsenali doli i pamposhtur nga "Stamford Bridge". "Ne luajtëm shumë mirë pas kartonit të kuq. Është shumë e vështirë, por ne e treguam

shpirtin e skuadrës. Ne po flisnim pas pjesës së parë dhe i thamë njëri-tjetrit se mund t'i arrijmë qëllimit. U kthyem dy herë në lojë dhe jam krenar për këtë skuadër", ka thënë Xhaka. "Pas ndeshjes, askush nuk do

të ketë pse të flasë për ne. Ne e treguam karakterin tonë të madh. Shumë njerëz kanë thënë se ne nuk kemi aspak karakter në skuadër, kështu që me këtë ndeshje ne e dëshmuam të kundërtën", ka shtuar Xhaka.



## FFK-ja së shpejti me zyra të reja

PRISHTINË, 22 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës shumë shpejt do të bëhet me zyra të reja. Pas shumë problemeve në këtë institucion tashmë krerët e kësaj Federate kanë vendosur për projektin e zyrave të reja. Këto zyra do të ndërtohen në vendin ku ata tanimë janë, mirëpo aty pritet të shtohet edhe një kat tjetër për stafin punonjës.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se stafi i kësaj federate tash e një kohë të gjatë ka nevojë të madhe për t'i rritur ambientet e punës. "Ju e dini që kohët e fundit kanë qenë aktuale pagesat që vijnë nga UEFA, burimet, fondet. Këto janë kryekëput për Federatën. UEFA dëshiron të ketë një filiale të vetën, një federatë të vetën e cila ka kushte moderne. Për këtë arsye ky ka qenë një ndër projektet kryesore në mënyrë që të funksionalizohet puna e administratës, sepse duhet që ata të kenë hapësirë të mjaftueshme. Ndërsa palët e interesuara të kenë hyrje të veçanta e jo të pengohet puna. Ju pe shihni edhe vetë si sekretar i përgjithshëm pothuajse s'mund të qëndrosh i qetë, ose kryetari sepse hyjnë palët të ndryshme", ka thënë Salihu, i cili ka zbuluar se ky objekt do të ndërtohet në tri faza



të ndryshme.

Ai ka bërë me dije se tanimë e kanë pronësinë e objektit ku gjendet dhe kjo ua ka lehtësuar punën për rregullimin e dokumentacionit për pajisje për leje të ndërtimit. "Do të bëhet në tri etapa. Për fat të mirë e kemi pronësinë, e kemi marrë falë vendimit të qeverisë Haradinaj, por me iniciativën e kryeparlamentarit Kadri Veseli... edhe kemi arritur në fazën që i kemi kryer të gjitha planet, të gjitha të detajuara se si do të duket selia e FFK-së. Kemi fat që në katin nëndhes e kemi shumë mirë. Kemi hapësira të mjaftueshme për pajisje sportive për fanella", ka shtuar ai. "Ne kemi menduar të fillojmë shumë më herët, por ju po e shihni se vazhdimisht po kemi probleme të ndryshme. Paralelisht do të punojmë edhe në stadiumin e KEK-ut si dhe në Hajvali, ku do të ndërtojmë një

stadium, një qendër të re teknike për grupmoshat tona, për futbollin e femrave dhe për drejtorinë teknike, në të cilën në të ardhmen mendojmë të mbajmë ligjërata, seminare, trajnime dhe licencime", ka deklaruar Salihu. Sa i përket çështjes së fondeve, Salihu u shpreh se ende nuk dihet saktësisht se sa do të kushtojë ndërtimi i këtyre zyrave, por sigurisht se në ditët e ardhshme FFK-ja do ta bëjë të ditur edhe një gjë të tillë. "Të them të drejtën nuk e di saktë, por do të ndërtohet faza-faza. UEFA HatTrick Committee quhet, i kemi dërguar sepse është dashur të marrim ekspertë për poshtë. I kemi dërguar masat, paralogaritjet për tri faza. Së pari bodrumin, pastaj katin e lartë, funksionalizimin e katit të poshtëm dhe objektin përreth. Në ditët në vijim mund të tregojmë saktësisht se sa parashihet", ka shtuar Salihu.

## Clippersat triumfojnë ndaj Dallasit

DALLAS, 22 JANAR - U zhvillua vetëm një ndeshje në NBA dhe përballë ishin dy nga skuadrat më të mira në Konferencën e Perëndimit, Dallas Mavericks e Los Angeles Clippers. Sfidat ishin interesante, ndërsa në fund pa skuadrën e Doc Rivers të triumfojë me rezultatin e ngushtë 107-110. Si gjithnjë, ai që e udhëhoqi ekipi kalifornian ishte superylli Kawhi Leonard që, edhe pse pa ndihmën e Paul George, i cili vijon të jetë i dëmtuar, ia doli ta thyente konkurrencën e Luca Donçiq e Krista Pozingis. Segmenti i parë ishte i ekuilibruar dhe u mbyll në barazim 24-24. Në fraksionin e dytë Clippersat u shkëputën edhe falë pikëve të Leonardit dhe ndihmës së Lou Williamsit ia dolën që në pushim të shkonin me avantazhin e 11 pikëve, 60-49. Mavericksi u zgjua në periodën e tretë dhe të drejtuar nga organizatori me



shumë përvojë JJ Barea dhe ia dolën që ta ngushtonin diferencën deri në -6, në një kohë që pikët e të përhershmit, super-talentit slloven Luka Donçiq, bën që në mbyllje të segmentit rezultati të ishte Dallas 78-Los Angeles 82. Sfidat në Teksas u ndez edhe më shumë në fraksionin përmbyllës kur Bogdan Marjanović barazoi rezultatin, 90-90, megjithatë Kawhi Leonard dhe trepikëshat e

Shamet e rikthyen në epërsi ekipin e Riversit. Hardaway nuk realizoi për tre dhe në këtë mënyrë fitorja u shkoi kalifornianëve të udhëhequr nga 36 pikët e 11 reboundët e Leonardit. Ky ishte sukcesi i 4-t radhazi dhe i 6-ti në 7 ndeshjet e fundit për Los Anxhelos, ndërsa nuk mjaftuan 36 pikët e 9 asistimet e Donçiqit që Mavsi ta evitonte disfatën e 16-të sezonale.

### SHKURT

#### Neurokirurgu italian zbulon gjendjen e Schumacherit

Michael Schumacher, tashmë 51-vjeçar, vazhdon që të luftojë me jetën, pas aksidentit me ski në dhjetor të vitit 2013, pas të cilit hyri në një gjendje kome. Por edhe pse tashmë 7 herë kampioni i botës në Formula 1 përfillet se ka dalë nga koma dhe po kurohet në kështjellën zvicerane ku jeton, në lumin e Gjenevës është neurokirurgu i spitalit të Bolonjës, Nikola Açari, që shqetëson fansat e tij. "Nëse për Schumacherin vazhdojnë të mos vijnë lajme pozitive, kjo do të thotë se gjendja e tij është e rënduar. Trauma cerebrale që ai ka pësuar ka ndikuar në strukturën e tij organike, muskulore dhe kockore. Pamja e tij mund të jetë shumë ndryshe nga ajo çfarë ne e mbajmë mend kur Schumacheri garonte në pistë", ka thënë neurokirurgu italian.

#### Kane, zëvendësues i Ronaldos në Juventus

Juventus ka filluar të mendojë për pasardhësin e Cristiano Ronaldos, i cili, edhe përkundër që po gëzon një formë të mirë, shumë shpejt i mbush 35 vjet. Mediat në Itali raportojnë se "Zonja e Vjetër" e ka vënë në shënjestër sulmuesin e Tottenham Hotspurit, Harry Kane. "Spurs" mund ta shesë kapitenin e vet vetëm për një shumë të majme, e cila, sipas mediave, është 160 milionë euro.

#### Odriozola përforcon Bayernin

Alvaro Odriozola është lojtari më i ri i gjigantit gjerman Bayern Munchen. Marrëveshja mes Bayernit dhe Real Madridit për lojtarin është huazim i thjeshtë gjashtë muaj. "FC Bayern Munich ka nënshkruar me Alvaro Odriozola si huazim nga kampioni spanjoll i rekordeve, Real Madridi, deri në fund të këtij sezoni. Pasi kaloi testet mjekësore, mbrojtësi i djathtë 24-vjeçar ka nënshkruar kontratën e tij në Sabener Strase dhe do ta fillojë stërvitjen me Bayernin", thuhet në njoftimin e Bayernit.

#### Emre Can, synim i Dortmundit

Borussia Dortmundi synon të përforcohet në repartin e mes-fushës. Emri kryesor në listën e klubit verdhezi është ai i Emre Canit, i cili te Juventus asnjëherë nuk ka arritur të marrë një rol protagonist dhe me uljen e Maurizio Sarrit në stol më tepër ka qenë jashtë formacionit. Turko-gjermani kryeson listën e lojtarëve që do të largohen nga bardhezinjtë, ndërkohë që për të ka treguar interes edhe Evertoni, pasi lojtari pëlqehet shumë nga Carlo Ancelotti.

#### Joshua mbron titujt ndaj Pulevit

Anthony Joshua dhe menaxheri i tij Eddie Hearn kanë arritur marrëveshjen që boksieri britanik t'i mbrojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë ndaj bullgarit Kubrat Pulev. Ky i fundit është i mandatuar nga IBF. Dy boksierët kanë afat deri më 31 janar për të arritur një marrëveshje, por duket se palët e kanë zgjidhur më herët këtë ngërç. Pulev, 38-vjeçar, nuk konsiderohet një rival i vështirë për Joshuan. "Ne jemi shumë pranë marrëveshjes dhe tani jemi duke kërkuar për një vend se ku do ta zhvillojmë këtë sfidë", u shpreh Eddie Hearn. Gjasat janë që kjo përballje të zhvillohet në Britaninë e Madhe, edhe pse nuk pritet të ketë shumë sukses, duke qenë se konsiderohet një sfidë e lehtë për britanikun.

<b>EPOKA ERE</b>		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>										<b>EPOKA ERE</b>
		KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO (shqip.)	TREGIMTAR, QË INFORMON, QË KALLËZON	DËSHIRË QË LË NJERIU ME FJALËT E FUNDIT PARA VDEKJES	MUAJ I VITIT	OHIO, LOUISIANA	REPART I SPITALIT KU LINDIN FOSHNJAT	ZANORE	NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË (shq.)	TRAJNERI KROAT ... BARIÇ	SHOK	
		SHQYEJ, ÇAJ NJË TRUP NË PJESE TË TIJ PËRBËRESE	◯									QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI
		SIGURESA ELEKTRIKE	◯					SHTET (huaj) UGANDA, LIBERIA				
		PEMË FRUTORE QË BËN KOKRRA ME LËVOZHGË TË FORTË	◯				KUJDESTARI (jur.) PJESE E VITIT (shq.)					
		GJYMTYRË SHUMË TË SHKURTRA NË KRAHASIM ME TRUPIN NORMAL (med.)	◯							ANA VISI SHKRONJA TË NJËJTA		
		I THARË (bised.)	◯						PËRSËRITËS (gram.)	TENISTJA KURNIKOVA SPIUNIA MË E NJOHUR E TË GJITHA KOHËRAVE		
		SILIC, TON	◯				SHPIRTI (Lat.) NJËZËSH-MËRI					BASHKËT. SHTERPËSI
		DY BASHKËTINGËLLORE	◯			VADITA TOKË E PUNUAR, POR E PAMBJELLË					PO (IT.) KITARISTI I SHQUAR KLEPTON	
<b>EPOKA ERE</b>	PORTOFOLI	SHTET NË AMERIKËN	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS " ... LORENZO"	↓	AJO QË BESON NË SHUMË HYJNI (pashq.) RRALLË (Lat.)	OSAKA	◯	BASHKIM I FORTË (sh.shq.) ZANORE				AKTORI FLOKO
PIRAT						SHIU I IMËT BASHKËT.	◯			ARKAT SHTETËRORE (lat.)		
STUHIA E FORTË ME ERE DHE SHI							◯	ALEN NURI VINÇ		KËNGËTARJA ADELINA VLERË, DOBI (krah.)		
QË KA TË BËJË ME HËNËN						QË PRODHOHET NË SERI BASHKËT.	◯			NDESHJE BASHKËT.		
EMPOLI, GROSETO			BASHKËT. PAVLEFSH-MËRI, PAVLERËSI (jur.)		MES I TRUPIT SËPATË E VOGËL (sh.shq.)		◯		EMËR I LASHTË PËR EGJIPTIN CEREMONITË FETARE		"LOKEREN" SHARRËZ	
RRUGË QË HAPET NËN TOKË						TRAJNERI TURK FATIH ..... JOD	◯			QYTET NË KOSOVË (pashq.) BASHKËT.		E PANDERSHME
"U" pas dy "A"				ADEM JASHARI ERMELINDA MEKSI			◯	KOHË, MOT (sh.shq.) DISIPLINË SPORTIVE		GAFORRE	SHKRONJË GREKE FUTBOLLISTI NIGERIAN MIKEL JOHN (CHELSEA)	
<b>EPOKA ERE</b>	SËMUNDJE E TOKËS KRYEQYTETI I LIBISË					SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI KLUB FUTBOLLI NË SPANJË				DREMIT NDNJUR SQUARE ARRAY KILOMETRE		
BASHKËT.		TERRITOR I IMAMIT (sh.shq.) PUNIM I ARËS								MODELI DHE AKTORI AMERIKAN ANTONIO PJESETAR I NJË FISILIR		
REMOTE ACCESS TECHNOLOGY			LLOJ LETRASH FATI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI						HUMANISTI BIÇIKEMI LLOJ SHPENDI I EGËR			BASHKËT. THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)
IRNOSET (bised.)					DAFINË PJESE E DITËS				GJITAR I DEVEVE POLARE BASHKËT.		NJËSI PESHE (vjet.) PËRËNDESHË E DASHURISË (mit. romake)	
KËPUCËT PËR RRËSHQITJE MBI AKULL								PYLL "RADIO TELEVISIONI ITALIAN"			FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT BASHKËT.	
OMANI, TANZANIA			MAKINË GËRRYESE RESHAT ARBANA						PREMTIM QË JEPET PËR TË BËRË DIÇKA NË NJË KOHË TË CAKTUAR NAIM OSMANI			BASHKË, TOK "MESINA"
NJËSIA MONETARE BAZË E ITALISË							VENDËS BASHKËT.				PJESE E SHTËPISË BASHKËT.	ZANORE
I PESHOVA						KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE CELINE ....					KAPELË E RRUMBULLAKËT PA STREHË DHE PA RRETH ANASH	

Selami Durmishi, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit, "MAX .TV" SHPK. Skenderaj me nr. 71350703.



**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë ) në 5000 Euro.

Shkelzen Hetem Bislimi shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj.

Ozata Transport and logistic shpall te pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër 71268241.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.  
Tel. 044-413-197.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

